

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7792 E mërkurë 13 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Intervista

Ditës

President, dua ta nis me një thënje të vitit 2010 për ju, që ju cilësoni si "personaliteti më pozitiv në politiken e jashtme". Si do ta cilësonit këtë vlerësim dhe ...

Vijon në faqen 20

Nga IAN PELHAN TURNER

Meta: E ardhmja e Ballkanit nuk është ndryshimi i kufijve



Opinion

Ditës

Dy hije të forta dyshimi qëndrojnë mbi kryet e opozitës për protestën e 16 shkurtit. E para ka të bëjë me seriozitetin dhe vendosmërinë e Lulzim Bashës ...

Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI

Hije dyshimi mbi protestën e 16 shkurtit



Femra e 5-të e vrarë që nga fillimi i vitit

Gardisti vret gruan në shtëpi me armën e shërbimit: Dyshoja se më tradhtonte

Policia arreston oficerin 44-vjeçar, gjatë sherrit qëilloi tri herë mbi bashkëshorten

Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese diskutoi edhe ndryshimin e projektligjit për koncesionet dhe PPP-të. Ministria e Financave propozoi që nga 1 korriku i këtij viti të mos jepet më asnjë projekt me PPP kur nuk ka një ofertë. Ndërkohë, deputetët e opozitës kanë qenë ata që kanë ngritur dyshime, ndërsa mes tyre deputeti Agron Shehaj ka ngritur ...

Në faqen 7

JO FJALIME ORATORESH, RRETHIM KRYEMINISTRISË DHE "NGUJIM" GJATE NATES

SKENARI I PD PER PROTESTEN. POLICIA: KUJDES NGA DHUNA

Rama tallet me Bashën: Po deshe pushtetin apliko te portali "Shqipëria që duam". Kreu i PD: Të shtunën finalja, do zihesh si mi në çark



(Në foto) Një nga protestat e Partisë Demokratike

Në faqen 3

PROJEKTILIGJI

Tarifa e re për rezervën e sigurisë, pritjet rritje tjetër e çmimit të naftës

Në faqen 5

EMRAT E TE ARRESTUARVE

Trafiku i drogës Shqipëri-Itali, shkatërrohen 4 grupe kriminale

Në faqen 6

ISH-MINISTRI

Fotoja me Ervin Salianji, Ahmetaj: E ftova për kafe që ta helmoja, s'e zuri

Në faqen 10

IMPORTUESIT

Vendimi për makinat e vjetra, tregtarët takojnë Ballukun: Kemi dëm ekonomik

Në faqen 11

I DENUARI PERJETE



Gjykata në Hagë refuzon ekstradimin e Arben Frrokajt, avokati: Tani, azil

Në faqen 7

Ekspertja rrëfen projektin ndihmës: Përfitojnë fëmijët dhe bashkëshortët

Bashkimi familjar në Itali, procedura e re

Beskida Aliaj: Trajnime para nisjes dhe ndihmë për dokumentacionin

NGA VOLTIZA DURO

Të gjithë shqiptarët që janë të interesuar të realizojnë bashkim familjar në Itali, tashmë mund të zgjedhin një rrugë më të lehtë dhe më të shpejtë duke u bërë pjesë e projektit FORMA. Përfutjes të këtij projekti janë fëmijët,



bashkëshortët dhe prindërit e shtetasve të huaj që kanë aplikuar për bashkim familjar, ku përfshihet edhe vendi ynë. Drejtoresha e patronatit INAS Albania, Beskida Aliaj, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" tregon se "FORMA" është rruga e bashkimit ...

Në faqen 9

PROTESTA E OPOZITËS KRYEMINISTRI

Kreu i qeverisë u shpreh se thirrja e Bashës për protestë është mesazh dashurie

Rama ironizon Bashën: Për pushtetin të aplikojë te platforma e qeverisjes

"Ai seriozisht e ka vetëm atë që nuk thotë"

Teksa opozita po bën organizimet dhe për gatitjet e fundit për të zbritur në shesh të shtunën, kreu i qeverisë Edi Rama duket se nuk e ka prishur shumë terezinë për atë që mund të prodhojë kjo protestë. Nga Lezha ku vijoi turin e tij të ri "Bashkia që duam", kreu i qeverisë nuk nguroi të ironizojë protestën e opozitës dhe vetë kreun e saj Lulzim Basha. Sipas tij Basha sa herë që del në protestë ka një hall dhe që kërkon ta zgjidhë me anë të thirrjeve për të rrëzuar qeverinë. "Edhe unë e kam pasur problem ta takoja. E prapë do të më takojë, po sa të bëjë pak sikur s'do. Dhe këtë 'sikur s'do' ai e ka me protesta, përmbyesje, revolucion. 'Hajde ta rrëzojmë', thotë. Por ky është mesazh dashurie, se nuk ka kurajën ta thotë hapur ku e ka hallin. Nuk është puna të ai se ai është artist, por unë habitem me këta që vazhdojnë dhe kujtojnë se ai e ka seriozisht. Ai seriozisht e ka vetëm atë që nuk thotë", tha Rama teksa ka marrë shkas nga një qytetar lezhjan që deklaroi në sallë se i ishte ankuar Bashës se e kishin hequr nga puna dhe se ai nuk i ishte përgjigjur. Por Rama nuk është ndalur me kaq, pasi në vijim të batutave që shkëmbeu me qytetarët e pranishëm në këtë takim, Rama theksoi se Basha po kërkon pushtetin në mënyrë të pamerituar ndërkohë që s'ka fituar asnjë palë zgjedhje. "Çdo shqiptar gjënë që e kërkon thotë se i takon. T'i shiko Lulin, s'ka fituar asnjë palë zgjedhje dhe thotë 'më takon pushteti'. Tani çfarë t'i bësh? Edhe ai të shkruajë te platforma, për 10 ditë i japim përgjigje", tha Rama. Ndërkohë që më tej ai u shpreh se Basha nuk i ka fjalët në sintoni me vëprat. Dhe për këtë ai iu referuar pikërisht faktit që ndër nga një krah kreu i opozitës kërkon veting për politikanët, nuk e ka fare problem që të dalë në krahë



Kreu i qeverisë Edi Rama, djeg në Lezhë

VETINGU

"Kur shoh kryetarin e opozitës në krah me kryetarin e Bashkisë së Lezhës, që ka akuzë për grabitje pronash dhe nuk lë gjë pa thënë në emër të drejtësisë, pastërtisë...them që ka një problem me ata që i shkojnë nga pas", - shtoi më tej Rama.

Pjerin Ndreu drejt Bashkisë së Lezhës, Rama e konfirmon

Pas Sotiraq Filos në Korçë, mazhoranca duket se po shkon drejt zyrtarizimit të një tjetri kandidat për kryetar bashkie për zgjedhjet e 30 qershorit. Në vijim të turit të tij "Bashkia që duam", kreu qeverisë është ndalur në Lezhë, ku i shoqëruar ishte nga deputetët Pjerin Ndreu dhe Lindita Nikolla. Gjatë takimit që zhvilloi në Lezhë me qytetarë në Pallatin e Kulturës, kryeministri Rama mori një propozim në sallë nga këngëtari popullor Mark Gjoka për të kandiduar për kryetar të bashkisë Lezhë, Pjerin Ndreu. Por Rama edhe pse ra dakord me propozimin tha se nuk ishin aty



për atë çështje. "Nuk kemi ardhur këtu për të zgjedhur kandidatët. Edhe unë me ty jam, por duhet ta lëmë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve", tha Rama. Pak ditë më parë ai ishte në qytetin e Korçës, ku edhe atje në një mënyrë gati të njësojtë duke

iu përgjigjur qytetarëve deklaroi se Korçës i duhej dhe për ka kohë kryebashkiaku aktual. Partia Socialiste ka përcaktuar 30 marsin si ditën kur do të bëj miratimin e kandidatëve për të gjitha bashkitë. Megjithatë deri më tani qoftë nga Rama ashtu edhe nga eksponentët të tjera të PS-së janë bërë publik disa emra potencial që do të përfaqësojnë PS në zgjedhjet e ardhshme. Kështu ndër emrat më të përfolur deri më tani, përveç Sotiraq Filos e Pjerin Ndreu janë edhe Erion Veliaj në Tiranë, Senida Mesi në Shkodër, Armando Subashi në Fier apo edhe Gledian Llatja në Elbasan.

qytetarë lezhjanë në kuadër të turit "Bashkia që duam" tha se ky qark do të këtë mbështetje të veçantë nga qeveria, ndërsa nënvizoi se këto ditë do të nisë ndërtimi i rrugës së Torovicës. "Sot patëm mundësinë të bëjmë disa vizita në sipërmarrjet e Lezhës, sipërmarrje njerëzish me opion dhe me vullnet dhe të gjithë më konfirmuan se sipërmarrja e tyre është

rritur. Se perspektiva e punës së tyre është më e mirë sot", - tha Rama. Shefi i qeverisë pohoi se ka plane për rritjen e agroturizmit dhe zhvillimit e zonave në qarkun e Lezhës, të cilët do të mbështeten përmes uljes trefish të taksës dhe shtimit të investimeve. "Këtë vit perspektiva është pozitive për sipërmarrjen, sepse kemi përgjysmuar ose më saktë ulja trefish e tak-



Një nga protestat e PD-së

PS kalon titujt e pronësisë, opozita: Ligji është klientelist

Pas dekretit për krijimin e Kadastrës, shumica qeverisëse kanë kaluar djeg në Komisionin e Ligjeve edhe një tjetër ligj shumë të rëndësishme që ka të bëjë me pronat dhe në mënyrë specifike me titujt e pronësisë së tokave të ish-ndërmarrjeve bujqësore. Deputetët e majtë votuan mes debateve projektligjin e propozuar nga Erion Braçe, ndërsa opozita u shpreh kategorikisht kundër këtyre propozimeve, të cilat ajo i konsideroi si klienteliste. Fatmir Mediu dhe Nasip Naço, si të vetmit përfaqësues të opozitës, e kundërshtuan pasi sipas tyre me këtë ligj tokat i përfitojnë edhe ata që nuk duhet t'i përfitojnë. "Në vend që këto toka të vihen si fond i kompensimit apo kthimit të pronave të pronarëve të ligjshëm, i çojmë akoma dhe më tej që t'ua japim atyre që nuk u takon, që i marrin sipas interesave politike dhe koniunkturës politike. Nuk mund të shikohet e drejta si numër votash", - tha Mediu. "Mënyra sesi e shtoni nuk e ndalon që ai që nuk ka qenë punonjës, por ka qenë banor i fshatit, të marrë tokën. Ligji është klientelist. Po i legalizoni të gjitha këto toka të marra, të mbajtura në mënyrë të paligjshme", - u shpreh deputeti i LSI-së, Nasip Naço. Por për mazhorancën, mënyra sesi përfitohet një tokë bujqësore është tashmë e rregulluar nga legjislacioni. Të gjitha shqetësimet që keni, janë të drejta, sa i takon moscenimit të së drejtës së pronësisë së subjekteve që mund të kenë pretendime, proces etj. Tokat bujqësore që mund t'i marrë sot fshatari që e përdor efektivisht, por nuk ka titull pronësie janë të eazuara në legjislacionin aktual", - tha Ferhati.



sës së fitimit për biznesin 140 mijë dollarë do t'i ndihmojë ata. Tek politika e re e agroturizmit. Do të ndërtojmë maternitetin e standardeve të fundit siç kemi bërë në Sarandë dhe në Korçë. Kemi investuar në disa qendra shëndetësore në kuadër të 300 qendrave shëndetësore, që i gjetëm të rrënuara plotësisht. Për pak ditë do të fillojmë rrugën e Torovicës.

Projekti është bërë. Kam porositur një palë gërsërë të gjata, që ta presë ky që ta kalojnë të majtë dhe të djathtë. Në atë zonë njerëzit mund të kthehen jo ndoshta për të jetuar, por për të punuar. Rruga tjetër është një aks strategjik Shëngjin-Velipojë, i cili do shërbejë jo vetëm për të zhvilluar këtë brez jo vetëm mes dy vendeve, por edhe me Malin e Zi", -shtoi ai.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llika Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotrafikëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



GAZMEND BARDHI

"Në një përpjekje të mjeruar, i rrethuar nga zhgënjimi, zemërimi dhe revolta e shqiptarëve, Edi Rama i vetmuar shfaq sot të gjithë pasigurinë dhe frikën e tij, kur urdhëroi Policinë e Shtetit të përhapë panik lidhur me protestën e 16 shkurtit. Skenari për të përdorur policinë si vegël politike është kriminal. PD garanton çdo qytetar për sigurinë e tij në datën 16 shkurt".



Braimllari: Provokatorët të rrinë larg protestës

LSI: Majko, si proamerikan, kryeministër i një qeverie tranzitore

Edhe LSI ishte dje në të njëjtën linjë me PD-në, teksa i kërkoi Policisë së Shtetit që ditën e shtunë të mbajë larg provokatorët. Deputeti Endrit Braimllari deklaroi se është kërkuar që "policia e shtetit të respektojë rendin dhe sigurinë politike dhe mos t'i shërbejë politikës". Ndërkohë, deputeti i LSI-së, Endri Braimllari tha se Policia e Shtetit duhet të shkëputet nga ndikimi politik i Edi Ramës, ndërsa e paralajmëroi atë që të heqë dorë nga provokimet në protestën e ditës së shtunë. "Policia e Shtetit duhet të shkëputet nga ndikimi politik i Edi Ramës, i cili ka treguar publikisht se nuk është në krah të oficerëve të ndershëm të policisë, por në krah të kriminit të organizuar. Paralajmërojmë Edi Ramën të mbajë larg provokatorët nga protesta e ditës së shtunë. I vetmi person që kërkon të destabilizojë është Edi Rama. Këtë, ai e ka vetëprovuar. Policia e Shtetit nëse ka informacion për elemente me rekorde kriminale, t'i luftojë dhe t'i godasë me forcën më të madhe, çdo ditë. Sot, nesër dhe pasnesër", u shpreh deputeti i LSI-së. Më herët në "Debatin në Channel One", Endrit Braimllari tregoi se kë beson se mund të jetë kryeministër i qeverisë tranzitore për të garantuar zgjedhjet me standarde. "Vetëm një qeveri tranzitore me një kryeministër tjetër do të jetë kushti që protesta të përfundojë. Nuk bëhet fjalë të ikë Rama dhe të vijë Basha, por të garantohet një proces zgjedhor i drejtë. Në këtë mënyrë një person brenda PS, por pa cilësitë e Ramës, që në besojmë për shembull është Pandeli Majko, i cili mund të garantojë zgjedhjen brenda standardeve" tha Braimllari.

Protestuesit do rrethojnë Kryeministrinë, PD: Rama të heqë dorë nga provokimi

Protesta pa limit e 16 shkurtit, zbardhet skenari i opozitës

PD: Garantojmë çdo qytetar për sigurinë e tij

Valentina Madani

Protesta e thërritur nga opozita më 16 shkurt në Tiranë pritet të ketë një pjesëmarrje masive, ndërkohë që ajo do të jetë pa limit në bulevard, deri në largimin e Edi Ramës. Drejtuesit e partive opozitare kanë marrë masa që një pjesë e madhe e protestuesve të mos largohen pas fjalimeve ditën e shtunë, por të qëndrojnë te Kryeministria për shumë ditë, deri sa kryeministri të largohet nga detyra. Burime brenda PD-së bëjnë me dije se protestuesit do të mbajnë të rrethuar Kryeministrinë deri në largimin e Edi Ramës nga detyra e kryeministrit dhe pritet që gjatë protestës të mos ketë fjalime të përfaqësuesve të opozitës. Në një deklaratë për mediat, Gazmend Bardhi në emër të PD i ka bërë thirrje Edi Ramës që "të heqë dorë nga çdo kërcënim dhe destabilizim", për protestën e lajmëruar nga opozita më 16 shkurt. "Skenari për të përdorur policinë si vegël politike është kriminal. Partia Demokratike garanton çdo qytetar për sigurinë e tij në datën 16 shkurt. Shqiptarët do t'i bashkohen protestës së opozitës, sepse e dinë mirë që kriminelët dhe bandat janë me Edi Ramën dhe jo me protestuesve. Ne do të protestojmë si njerëz të lirë dhe me dinjitet", deklaroi sekretari i përgjithshëm i PD. Më herët ai garanoi qytetarët se siguria e tyre nuk do të cenohet gjatë protestës së 16 shkurtit para Kryeministrisë. Ai deklaroi se demokratët do të protestojnë si njerëz të lirë dhe me dinjitet, ndërsa paralajmëroi policinë që të rrijë larg protestuesve. "Të mos pengojë lëvizjen e lirë të tyre! Përndryshe, secili prej shërbëtorëve të skenarit kriminal të Edi Ramës do të mbajë përgjegjësi personale dhe ligjore! Në Shqipëri ka vetëm një skenar destabilizimi. Ai është skenari i Edi Ramës për të qeverisur bashkë me krimin e organizuar, i cili blen vota dhe mandate për të mbajtur në pushtet Edi Ramën", u shpreh Z. Bardhi. PD-ja shprehet se kryeministri ka vetëm një detyrë, t'i hapë rrugë zgjidhjes politike! "I bëjmë thirrje të heqë dorë nga çdo skenar destabilizues që ka mbi tryezën e tij! Në të



"Të shmangen retorikat që nxisin dhunë"

Policia: Në protestën e 16 shkurtit, individë me precedentë synojnë destabilizimin

Policia e Shtetit shprehu dje shqetësimin se në protestën e 16 shkurtit, të thirrur nga opozita janë të përfshirë individë me precedentë penalë apo të nxitur nga aktorë të tretë, të cilët synojnë krijimin e një klime destabiliteti në Shqipëri. Përmes një deklarate për mediat njoftohet se: "Policia e Shtetit u bën apel forcave politike të angazhuara për tubimin e datës 16 shkurt që të shmangen retorikat, të cilat nxisin veprime kundër rendit e qetësisë publike". Po ashtu, policia u bën thirrje qytetarëve që të kufizojnë lëvizjet në 16 shkurt. "Duke garantuar të drejtën e tubimit dhe lirinë e shprehjes së qytetarëve që manifestojnë për pikëpamjet e tyre politike, Policia e Shtetit u bën thirrje të gjithë qytetarëve që s'kanë lidhje me këtë tubim, të marrin masa për kufizimin e lëvizjes së



kundërt, Edi Rama do të jetë i vetmi që do të mbajë përgjegjësi, nëse si çdo diktator që del kundër vullnetit të popullit të bashkuar! Ftojme shqiptarët të inorojnë kërcënimet e një pushteti të kalbur nga krimi dhe korrupsioni!", theksoi sekretari i përgjithshëm i PD-së. Më herët në studio televizive, në analizën e sekretarit të përgjithshëm të PD, Edi

marrësve të saj dhe të qytetarëve të tjerë. "Po ashtu, Policia e Shtetit ndan me publikun shqetësimin për përfshirjen në atë tubim të individëve me precedentë penalë apo të nxitur nga aktorë të tretë, të cilët synojnë krijimin e një klime destabiliteti në Shqipëri", - thuhet në deklaratën e Policisë së Shtetit.

kanë lidhje me PS, por janë shokë dhe miq të Edi Ramës ose gruas së tij. Nuk është një betejë mes forcave politike, por një qeverie që e ka lidhur fatin e vet me krimin dhe jo me qytetarët. Prandaj, 16 shkurti nuk është protestë politike, por është qytetare. Edhe pse ka 75 deputetë, Rama do të rrezohet nga presioni i popullit", - theksoi sekretari i përgjithshëm i PD.

Rama është sot jo vetëm një kryeministër ilegjitim, por edhe i vetmuar, pa mbështetje dhe shumicës së qytetarëve, përfshirë edhe socialistët. "Në protestë do të ketë edhe socialistë, të cilët na kanë pritur gjatë takimeve tona në qytetë të ndryshme të vendit. Janë të zhgënjyer, sepse e kanë parë që kjo nuk është qeveri e PS, por qeveri e Edi Ramës. Gjysma e ministrave nuk

OPOZITA TAKIMET

Kreu i PD, në ish-kampin e Tepelenës: Fund kultit i krimit i trashëguar nga diktatura

Basha, Ramës: Zgjidhje politike, ose shqiptarët të nxjerrin nga zyra

"Të shtunën finalja, do i zëmë në çark si minj"

Valentina Madani

Nga Pogradeci dhe Elbasani, kreu i PD-së, Lulzim Basha, i dha dje ultimatum Edi Ramës deri të premtën e 15 shkurtit për të gjetur zgjidhje politike. Në të kundërt sipas tij, të shtunën e 16 shkurtit shqiptarët do ta tërheqin zvarrë nga zyra. 16 shkurti për kryetarin e opozitës do të shënojë ditën e rikthimit të shpresës. Ish-pronarëve u premtim shfuqizim të ligjit të pronave. Basha akuzoi mediat se kanë censuruar zërin e opozitës për mbështetjen që i ka dhënë kësaj shtrese. Kreu i PD, Lulzim Basha, iu përgjigj kryeministrit Edi Rama, i cili tha se do të marrë Bashkinë e Pogradecit. Nga qyteti liqenor, Basha i tha Ramës se i ka bërë hesapet me kriminelët dhe jo me qytetarët. "Këtu nga Pogradeci hodhi sfidën se do ta marrë Bashkinë e Pogradecit. Por i ke bërë hesapet me Niçen, i ke bërë hesapet me krimin, nuk i ke bërë hesapet me popullin dhe të janë verbuar sytë. Do marr këtë, do marr atë. Tani nga Pogradeci dua t'ia them shokur dhe qartë: Nuk je kryeministri i shqiptarëve, je kryehajdut, kryetrafikant. Deri të premtën në 15 shkurt ke kohë të hapësh rrugën dhe t'i japësh zgjidhje politike, më 16 shkurt populli do të të trajtojë si kryeqen, si kryehajdut, si kryetrafikant", deklaroi z.Basha. Edhe nga Elbasani, kreu i PD-së bëri një paralajmërim të fortë kur tha se të shtunën qytetarët do i zënë si minj në kryeministri. "Kjo është finalja. Në 16 shkurt është finalja. Është i gjithë populli kundër një grupi njerëzish. Janë të gjithë bashkë kundër një grupi. Me ne do jenë të gjithë studentët e të gjithë Shqipërisë. Me protestuesit do jenë të gjithë sipërmarrësit e ndershëm. Njerëz që i kanë goditur padrejtësisht me taksat. Do jenë të papunët që kanë 5 vjet që kërkojnë dhe s'kanë



Kreu i PD-së Lulzim Basha, dje në Elbasan

AKUZA

"Nuk je kryeministri i shqiptarëve, je kryehajdut, kryetrafikant. Deri të premtën në 15 shkurt ke kohë të hapësh rrugën dhe t'i japësh zgjidhje politike. Më 16 shkurt populli do të të trajtojë si kryeqen, si kryehajdut, si kryetrafikant", deklaroi z.Basha.

Platforma e bashkëpunimit firmoset para 16 shkurtit

Aleatët mbështesin Bashën: Të diskutojmë për reformën zgjedhore

Aleatët e Lulzim Bashës, platformën e bashkëpunimit e shohin si një dokument parimesh dhe listë sfidash që kërkojnë përgjigje. Kreu i PR-së, Fatmir Mediu, deklaroi se marrëveshja krijon një hapësirë institucionale që përcakton qëllimet e qarta politike për çdo forcë opozitare. "Padyshim marrëdhënie elektorale të qenësishme për të garantuar një proces zgjedhor të lirë dhe të ndershëm dhe e dyta për të garantuar një ndryshim politik, që është i domosdoshëm në Shqipëri përballë një situatë të papranueshme që ka të bëjë jo vetëm me varfërinë, por me kontrollin që ka krimi dhe korrupsioni i lidhur me qeverinë në këtë vend", u shpreh Mediu për "Ora News". Edhe Dashamir



Shehi i LZHK-së vlerëson platformën, ndërsa shprehet se opozita objektiv të qartë duhet të ketë largimin e Ramës. "Shërben si një bazë mbi të cilat nesër, pasnesër do të negociojmë të gjitha palët", deklaroi Shehi. Të gjitha pikat e platformës kërkojnë një zhvillim të mëtejshëm, mes forcave politike opozitare. "Për një parlament kushtetues në radhë të parë, që të

populli kundër një grushti njerëzish që na ka marrë peng. Të shtunën i gjithë populli do i zërë ata në çark si minj", theksoi z.Basha.

VIZITA

Lulzim Basha i shoqëruar nga deputetët të PD-së dhe disa të mbijetuar të ish-kampit të internimit të Tepelenës, mes të cilëve Simon Miraka, dëgjoi dëshmitë e tyre për kushtet e shfarosjes

jetë përfaqësues i qytetarëve, një parlament të përgjegjshëm që t'u japë llogari qytetarëve dhe njëkohësisht për të shmangur manipulimin e zgjedhjeve. Një sistem zgjedhor me lista të hapura për gjykimin tim është sistemi më i drejtë. Kjo mbetet për tu diskutuar dhe analizuar dhe me kolegë të tjerë të opozitës", deklaroi z.Mediu. Kurse z.Dashamir Shehi u shpreh: "Kur të vijë puna për çështjet e Kodit Zgjedhor këtu mundet që nuk jemi të gjithë dakord, por kjo është një temë që sigurisht do të diskutohet më vonë". Platforma është një marrëveshje parimore mes forcave politike, ndërkohë Partia Demokratike si forcë kryesore në opozitë ngarkohet të negociojë në mënyrë individuale me çdo forcë nënshkruese.

që ekzistonin në të. Basha tha se kushtet e këtij kampi u ngritën sipas parimit të shfarosjes, i cili u zbatua më herët edhe nga nazistët. "Nga pikëpamja ligjore, ky është krim kundër njerëzimit, sepse në qoftë se 1 në 3 humbën jetën për shkak të kushteve qëllimisht shfarosëse, çnjerëzore, atëherë këtu bëhet fjalë për kamp shfarosjeje. Duke qenë se



Kreu i PD-së Lulzim Basha në ish-kampin e internimit në Tepelenë

Berisha: Polici tentoi të përdhunonte studenten

Ish-kryeministri Sali Berisha denoncoi dje një emërim të bërë së fundi, pas furtunës në radhët e komandës së Forcave Detare, pas hetimit për vjedhjen e armatimeve në bazën e Pashalimanit. Sipas Berishës, de facto komandant i Forcës Detare të vendit është emëruar Artur Meçollari, të cilin ish-kryeministri e quan spiun të agjenturave të huaja. Kujtojmë se Meçollari ka qenë pjesë e grupit negociator të Shqipërisë për paktin detar me Greqinë, ndërkohë që Berisha denoncoi që në atë kohë se ai ishte një spiun i grekëve. "Spiuni Artur Meçollari emërohet nga Zografi bis de facto komandant i Forcës Detare të vendit!", shprehet z.Berisha. Po dje ish-kryeministri publikoi denoncimin e një studentit që flet për një rast tentative përdhunimi në dyert e Universitetit të Shkodrës. Denoncuesi shprehet se një punonjës policie, efektiv i FNSH-së i veshur civil ka ngacmuar vajzat e fakultetit juridik dhe njerën ka tentuar ta përdhunojë, por është kapur në kohë nga studentët që e kanë mbyllur në banjë. Gjithsesi, sipas studentit polici nuk është arrestuar.



gjithçka u zhvillua edhe pa legjislacionin që diktatura e përdorte për të burgosur dhe për të ekzekutuar kundërshtarët e regjimit dhe u drejtua kryesisht kundër familjarëve të tyre, nuk ka asnjë diskutim se edhe motivi i xhelatëve që i sollën këtu, edhe mënyra e veprimit këtu kishte një qëllim, shfarosjen e tyre", theksoi z. Basha. Ai u njoh me kushtet e tmerrshme nga i mbijetuari i kampit famëkeq të Tepelenës, Simon Miraka. Ai tregoi se ka hyrë 4 vjeç në kamp, në vitin 1944 dhe ka dalë 9 vjeç nga kampi. Gjatë rrëfimit të tij, i mbijetuari Simon Miraka u shpreh se kanë vdekur mbi 1 mijë njerëz të pafajshëm në këtë kamp duke përfshirë fëmijë, gra e burra. "Këtu kanë qenë 5 kazerma

të bëra nga italianët dhe kjo ka shërbyer si komandë e policisë. Pjesa këtu shërbente si furrë bëkë, bukë e zezë sterrë. Ndahej dhe bollgur me krimba. Këto shkaktoan edhe epidemi për sëmundje të ndryshme. Kazanët e gjellës ishin fuçia që u kishin shërbyer italianëve për naftë. I prenë ato, i sharruan dhe i bënë kazanë. Ai spirilëngu, ajo gjella e famshme, e quajtur gjellë, se gjellë s'ishte, kur shkonin njerëzit për ta marrë me tasa a gaveta, ishte gjithë pisllek e naftë. Këto shkaktoan epidemi, zgjebën, kolerën dhe sëmundje të ndryshme. Vdekjet filluan me 32 vetat e parë dhe vazhduan këtu me 300 fëmijë, moshë nga 6 muaj deri në 3-4 vjeç", tregoi Simon Miraka.



TARIFA

"Tarifat e krijimit dhe mbajtjes së rezervës së sigurisë për detyruesit do arkëtohen nga Autoriteti Doganor gjatë mbledhjes së detyrimit doganor të mallrave me akcizë dhe paguhen në llogarinë e 'Agjencisë'. Paguesit e tarifës së sigurisë janë të detyruar që brenda afatit prej 30 ditësh pas përfundimit të muajit kalendrik në të cilin paguhet pagesa e kësaj tarife të dorëzojnë të dhënat në lidhje me pagesën e realizuar pranë 'Agjencisë'".

Zbardhet projektligji i ministrisë për krijimin e rezervës së sigurisë së naftës

Drafti, rritet sërish çmimi i naftës, qeveria propozon tarifë të re

Tarifa do ndikojë në rritjen e çmimit të arit të zi

Çmimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në treg pritet të rritet sërish. Krahas taksave dhe tarifave që rëndojnë konsiderueshëm në çmimin e arit të zi në vendin tonë, do të përfshihet edhe një tarifë e re. Bëhet fjalë për tarifën e rezervës së naftës, që do jetë e detyrueshme të paguhet nga çdo importues apo tregtar me shumicë dhe që për rrjedhojë pritet të shkarkohet te konsumatorët fundorë, pra qytetarët. Ministria e Transporteve dhe Energjetikës ka përgatitur një draft-ligj me anë të të cilit parashikon të ngrëjë Rezervën e Sigurisë së Naftës në Shqipëri, që do të krijohet kryesisht nga kontributi i importuesve dhe tregtarëve të naftës dhe që



do të menaxhohet me miratimin e këtij projektligji nga shteti.

PROJEKT-LIGJI

Projektligji i hartuar nga Ministria e Transporteve dhe Energjisë dhe që u është paraqitur për mendim grupeve të interesit dhe aktorëve të fushës parashikon mbajtjen e rezervës së sigurisë nga një Agjenci shtetërore dhe jo nga industria, siç është aktualisht. Qëllimi i kësaj nisme është sigurimi i sasisë së produkteve energjetike hidrokarbure, të cilat do jenë në dis-

pozicion ose nën kontrollin e Këshillit të Ministrave dhe të cilat do të krijohen për të siguruar një nivel të lartë të sigurisë së furnizimit në vend, për të ruajtur sigurinë kombëtare, për të kryer detyrimet, të pranura sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe për të garantuar jetesë normale për popullin. Arritja e këtij objekti sipas këtij drafti do të realizohet në mënyrë të përkallëzuar deri në fund të vitit 2022, në mënyrë të tillë që edhe efektet ekonomike që shkakton ky zëvendësim

të jenë të pranueshme dhe të përballueshme. Për këtë qëllim është parashikuar hartimi i një plani veprimi, i cili do të detajojë mbajtjen e rezervës së sigurisë deri në fund të vitit 2022, ku industria do mbajë 30 ditë mesatare shitje, ndërsa 'Agjencia' do të ndërtojë në mënyrë graduale pjesën e saj të rezervave. Sipas këtij drafti, rezerva e sigurisë në Republikën e Shqipërisë duhet të jetë të paktën 90 ditë e sasive të importeve mesatare ditore neto, ose të paktën 61 ditë të mesatare ditore të sasive të konsumit të brendshëm.

TARIFA

Ndërkohë që barra për krijimin e kësaj rezerve duket se do të bjerë tek importuesit dhe tregtarët e shumicës dhe nëpërmjet tyre te qytetarët. Kjo, pasi në mesin 17 të projektligjit me titull "Metodat e financimit", përcaktohet se fondet e dedikuara për mbulimin e shpenzimeve për krijimin, ruajtjen, mirëmbajtjen, inspektimin e rezervave të sigurisë, si dhe për aktivitetet e tjera të rregullta të agjencisë sigurohen nga: a) Tarifat e krijimit dhe mbajtjes së rezervës së sigurisë që aplikohen mbi sasitë e produkteve energjetike hidrokarbure, b) Kreditë, c) Të ardhurat nga shitja e rezervave d). Të ardhurat nga shitja e shërbimeve. "Me qëllim financimin e krijimit, mbajtjes dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë së naftës dhe nënprodukteve të saj është parashikuar dhe vendosja e një tarife për këtë qëllim. Kjo tarifë do të jetë pjesë e çmimit të karburanteve, e cila do të paguhet nga shoqëritë e tregtimit me shumicë", thuhet në relacionin që shoqëron projektligjin. Ndërkohë që në mesin 18 të tij përcakton personat e detyruar për pagesën e tarifës, se, "Tarifat e krijimit dhe mbajtjes së rezervës së sigurisë, për detyruesit do arkëtohen nga Autoriteti Doganor gjatë mbledhjes së detyrimit doganor të mallrave me akcizë dhe paguhen në llogarinë e 'Agjencisë'. Paguesit e tarifës së sigurisë janë të detyruar që brenda afatit prej 30 ditësh pas përfundimit të muajit kalendrik në të cilin paguhet pagesa e kësaj tarife, të dorëzojnë të dhënat në lidhje me pagesën e realizuar pranë 'Agjencisë', - thuhet në relacion.



Krijohet agjencia e re, ja si do përdoret rezerva e naftës

Agjencia Shtetërore e Rezervave të Sigurisë të Naftës (ASHRSN) do jetë institucioni përgjegjës për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë dhe do jetë i vetmi organ në Republikën e Shqipërisë, i autorizuar për të blerë, të magazinonjë, të menaxhojë dhe të tregtojë rezervat e sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukte të saj, për qëllime të këtij ligji. Këshilli i Ministrave mund të nxjerrë një vendim me të cilin vendos krijimin dhe mbajtjen e rezervave specifike, si pjesë e rezervave të sigurisë dhe duhet të përfshijë një listë të produkteve energjetike hidrokarbure, që do të përdoren për krijimin dhe mbajtjen e rezervave specifike. Në rast të ndërprerjes së furnizimit të tregut me nënprodukte të naftës bruto, Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit merr vendim për përdorimin e rezervave të sigurisë, në përputhje me Planin Kombëtar të Reagimit, duke përfshirë përcaktimin e çmimit të hedhjes në treg dhe mënyrën e përdorimit të rezervave të sigurisë.

TENDER NOTIFICATION

FOR CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RESCUE AND FIRE FIGHTING STATION (RFFS) BUILDING TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for construction of New Rescue and Fire Fighting Station (RFFS) Building.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist in general terms of: securing of the site, preparatory works, soil removal and excavations, drainage works, structural works, interior and exterior finish works, mechanical and electrical systems, external infrastructure including surrounding related pavement works, demolition of existing building and construction of the sport facilities.

To participate in this process interested parties shall submit officially in written form the expression of interest by letter at TIA premises. After receipt of the expression of interest until deadline 15 of February 2019, TIA will provide via email the Invitation to Tender and Confidentiality Commitment Document together with the respective forms. These documents and forms must be submitted filled and signed accordingly to TIA, Administration Building, Rinas, until 18 of February 2019.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms, prequalified based to specified qualifying criteria, will be given the respective set of Instruction to Tenderers with tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge to the prequalified companies, in a CD, on 20 of February 2019.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RFFS BUILDING" The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs on 18 March 2019**. Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK
Administration Building, Rinas, Tirana, Albania
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com

Policia: Arrestimet në dy vendet fqinje, 21 nga të akuzuarit, shqiptarë

TIRANË

Katër grupe kriminale që trafikojnë kanabis nga Shqipëria në Itali janë shkatërruar gjatë një operacioni të zhvilluar nga policia italiane në bashkëpunim me Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe policinë shqiptare. Mësohet se 20 persona janë vënë në pranga dhe 7 të tjerë janë shpallur në kërkim, si rezultat i një hetimi nisur në vitin 2016. Burime zyrtare nga Policia e Shtetit dje bënë me dije se janë lëshuar 27 urdhër arreste, nga të cilat 21 për shtetas shqiptarë dhe 6 për shtetas italianë. Po të njëjtat burime sqaruan se 6 shqiptarë u arrestuan në Vlorë, gjashtë në Itali, një është në burg në Shqipëri (1 kapur në vitin 2017) dhe tjetri në Malin e Zi, ndërsa shtatë janë në kërkim, duke e dërguar numrin në 21. Përsa u përket italianëve që janë të përfshirë, katër janë arrestuar ditën e djeshme përtej Adriatikut, ndërsa dy janë në burg në Shqipëri, pasi u kapën në 2017-ën. Operacioni i koduar "Lulet e Pranverës" është shtrirë në disa qytete të Shqipërisë dhe konkretisht në Durrës, Vlorë dhe në Lezhë, ndërsa janë dokumentuar katër raste të trafikut. Gjithsej janë sekuestruar në të dyja vendet rreth 3.5 tonë kanabis. Në Itali operacioni është zhvilluar në Kalabri, Toskanë, Emilia Romagna, Sicili dhe Lombardia. Hetimet kanë zgjatur dy vite. Personat e arrestuar janë të akuzuar për krijimin e organizatave kriminale në trafikun ndërkombëtar të drogës nga Shqipëria në Itali. Droga nga Shqipëria trafikohet drejt Italisë duke u shpërndarë më pas në vendet e tjera të Europës, mes të cilave në Gjermani e Zvicër. Grupet kriminale bazën e kishin në Leçe. Në operacion u angazhuan mbi 100 efektive. Operacioni i kësaj të hënë erdhi 10 ditë pas vizitës së kreut të Antimafies italiane në Shqipëri, Federico Caffero De Raho. Përmes një videokonference nga Italia, ai u shpreh se këtyre grupeve, përveç trafikut të drogës u është faktuar edhe trafiku i armëve. Hetimet përgjatë dy vitesh kanë bërë të mundur që të identifikohen dhe kapen pjesëtarët e 4 grupeve kriminale italo-shqiptare me baza operative në provincën e Leçes dhe degë në rajonet e tjera italiane dhe të gjithë përgjegjës për trafik ndërkombëtar droge, posedim dhe futje në territor italian të armëve dhe municioneve ushtarake. Me anë të një videokonference nga Italia, prokurori i Antimafies, De Raho tha se shkatërrimi i katër grupeve kriminale është bërë nga një skuadër e përbashkët mes Shqipërisë dhe Italisë. Sipas tij, sasia e drogës që trafikojnë këto grupe kriminale me qendër në Leçe kishte si destinacion vendet europiane.

Trafiku i drogës nga Shqipëria në Itali, shkatërrohen 4 grupe kriminale

Operacioni i koduar "Lulet e Pranverës", 20 persona në pranga dhe 7 në kërkim



Operacioni i koduar "Lulet e Pranverës"



LECCE PR

OPERACIONI I KODUAR "LULET E PRANVERËS"

PERSONAT E ARRESTUAR NË SHQIPËRI

- Denis Pashaj
- Kristjan Llanaj alias Nuredinaj
- Luka alias Kriols Beqiraj
- Arbnor Xhimal alias Hoxhaj
- Bilbil Kabelle
- Kujtim Elmazi

PERSONAT E ARRESTUAR NË ITALI

- Dorian Alikaj
- Altin Avduramani
- Ajet Çepaj
- Klaudio Fani
- Artur Malo
- Raul Zenunak
- Giancarlo Desimone
- Gianfranco Conestabile
- Salvatore Santoro
- Francesco Tarantini
- Giuseppe Vanatagiato

PERSONAT NË KËRKIM

- Arben Pazi, 42 vjeç alias Beni.
- Bernard Tahiraj, alias Benard Shametaj, 32 vjeç
- Dorjan Pashaj, 34 vjeç
- Elvin Xamo (alias Gozhda), 40 vjeç
- Erjon Xhelili, 36 vjeç
- Fatmir Xhelili (alias Miri), 38 vjeç
- Nertil Gerra, 31 vjeç

NË BURG

- Dino Abazi (alias Loku)
- Eduart Sallaku, 50 vjeç

AKUZAT NDAJ TË ARRESTUARVE

Personat e arrestuar gjatë operacionit të koduar "Lulet e Pranverës" akuzohen për veprat penale krijimi i organizatave kriminale, trafik ndërkombëtar të drogës, armëve dhe municioneve nga Shqipëria drejt Italisë dhe më pas në vende të tjera. Në këtë operacion morën pjesë 100 efektive dhe pas dy vitesh hetime është bërë e mundur kapja dhe arrestimi i të përfshirëve, të cilët rezultojnë si pjesë e katër grupeve kriminale.

TRAFIKU I DROGËS, JA 4 RASTET E DOKUMENTUARA

■ NGA POLICIA ITALIANE DHE SHQIPTARE

Më 10 shkurt 2017, në vendin e quajtur Godull Adriatik është gjetur dhe sekuestruar një gomone me 1.6 tonë kanabis.

Më 26 shkurt 2017, në Brindisi është sekuestruar një gomone me 966 kg kanabis, u arrestuan dhe dënuan Eduard Sallaku dhe italiani Donato Carluçi.

Më 5 prill 2017, në Gjirin e Lalzit u sekuestrua një motoskafe që dyshohet se do të trafikonte kanabis drejt Italisë, ndërsa u arrestuan dy skafistët italianë: Gianfranco Mariano dhe Donato Carluçi, kanabisi ishte siguruar nga Eduard Sallaku.

Më 2 qershor 2017, në Vjosë u sekuestrua një gomone me 685 kg kanabis, ndërsa u arrestua Dino Abazi.



Operacioni, reagon Lleshaj: Çmontim i krimit të organizuar

TIRANË - Pas goditjes së katër grupeve kriminale dhe arrestimit të 27 personave në bashkëpunim me Italinë ka reaguar edhe ministri i Brendshëm, Sander Lleshaj. I pari i Ministrisë së Brendshme shkruan mes tjerash se operacioni për shkatërrimin e grupeve të strukturuar kriminale është një tregues i qartë se Italia dhe Shqipëria do të çmontojnë me "thel" raste të tilla. Pas dy vitesh hetime intensive nga të dyja anët e Adriatikut u bë i mundur arrestimi i 27 trafikantëve, mes tyre 21 shqiptarë dhe 6 shtetas të tjerë italianë. "Një tjetër goditje e rëndësishme për krimin e organizuar ndërmjet Shqipërisë e Italisë. Finalizimi i operacionit të përbashkët mes policive të të dyja vendeve, një provë tjetër e qartë e vullnetit dhe e kapaciteteve për çmontimin e krimit të organizuar. Operacioni vazhdon...", shkruan Lleshaj.

I arrestuar në Itali për vjedhje, gjykata nuk i kthen mandatin Gledian Rehovicës

TIRANË - Gjykata Administrative ka rrëzuar dje kërkesën e ish-deputetit të Lëvizjes Socialiste për Integritet, Gledian Rehovica për t'u rikthyer në Kuvend si deputet. Lajmi konfirmohet për "BalkanWeb" nga gazetarja Klodiana Lala. Ish-deputeti kërkoi shfuqizim të vendimit të KQZ-së dhe rikthimin e mandatit të deputetit në qarkun e Beratit, hequr rreth një vit e gjysmë më parë. Rehovica bashkë me Aqif Rakipin nga radhët e PDIU-së ishin të parët në listën e deputetëve që u prekën nga ligji i dekriminalizimit. Hetimet e prokurorisë dolën në përfundimin se Rehovica kishte fshehur nga formulari i vetëdeklarimit një vepër penale të kryer në Itali. Ai akuzohej se ishte arrestuar në vitin 1999 në shtetin fqinj për "vjedhje të një dyqani". Rehovica mohoi akuzat duke u shprehur se në kohën për të cilën akuzohet ishte student në Romë.

TIRANË - Gjykata e Apelit me seli në Hagë ka refuzuar ekstradimin e Arben Frrokut. Lajmi konfirmohet për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" nga avokati Tonin Prendi. "Ai refuzon kërkesën e shtetit shqiptar për të ekstraduar vendim që është apeluar në Gjykatën e Apelit. Ky është një vendim, i cili hap rrugën lirimit të Arben Frrokut në shtetin holandez. Ka procedura të tjera dhe i lind e drejta të kërkojë azil politik. Pretendimet



Arben Frroku

Arben Frroku drejt lirisë, avokati: Gjykata në Hagë refuzon ekstradimin

janë ato që dihen nga të gjithë, madje edhe nga opinioni publik. Nuk ka asnjë provë që çon implikimin e këtij në këtë ngjarje. Në rastin konkret të kemi parasysh që nuk është hapur as çështja fare, por thjesht një gjykim i të gjitha fakteve. Vendim që është ankmuar edhe në Gjykatën e Strasburgut. Ne insistojmë në faktin

që do ta pranojë edhe pa prova, një vendim i marrë nga shfrytëzimi politik në media mbi prova që janë në dosje", tha avokati. Arben Frroku u arrestua në Selanik për vrasjen e komisarit Dritan Lamaj, por arriti të fitonte pafajësinë në Gjykatën e Shkallës së Parë në vitin 2015 dhe u arratis nga Shqipëria pikërisht në momentin që

çështja ndodhej në Apelin e Krimeve të Rënda. Kjo gjykatë vendosi të rrezonte vendimin e Shkallës së Parë dhe ta dënonte atë me burg të përjetshëm. Një vit më vonë në 2016-ën, Frroku arrestohet në Holandë, atje ku pretendon të fitojë azil me justifikimin që ekstradimi drejt Shqipërisë do ta diskriminonte politikisht.

Arrestohet 44-vjeçari. Fqinjët: Jemi të tronditur, ishin familje e mirë

TIRANË

Cmbenden burrat në Shqipëri! Nuk kanë më arsye. Në 40 ditët e para të këtij viti janë ekzekutuar katër gra dhe një vajzë 18 vjeçe. Krimi i radhës brenda familjes u shënua mëngjesin e djeshëm në Tiranë. Një punonjësi i Gardës së Republikës qëlloi për vdekjen me armën e shërbimit bashkëshorten 36-vjeçare, Ervilma Seferaj. Bëhet fjalë për 44-vjeçarin Alket Arapaj, i cili përfundoi në pranga, ndërsa dyshohet se e ekzekutoi të shoqen me tre plumba për motive xhelozie. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ngjarja e rëndë që tronditi banorët e kryeqytetit ndodhi në katin e katërt të një pallati pranë shkollës "Bajram Curri" në Allias. Kanë qenë fqinjët, të cilët pasi kanë dëgjuar krismat e armës, kanë njoftuar policinë. Pas sinjalizimit për krimin në familje, blutë ka shkuar shpejt në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet. Dyshohet se e gjithë skena e krimit ka ndodhur në sytë e vajzës 3-vjeçare të çiftit. Ndërkohë, gjatë marrjes në pyetje punonjësi i Gardës është shprehur se e vrau gruan e tij, pasi e tradhtonte.

VRASJA

Sipas burimeve policore, vrasja e 36-vjeçares Ervilma Seferaj ka ndodhur rreth orës 06:00 të ditës së djeshme. "Shërbimet e Policisë të Komisarariatit Nr.4, në bashkëpunim me SHÇBA arrestuan në flagrancë shtetasin A. A., 44 vjeç (punonjësi në Gardën e Republikës). Rreth orës 06:00 të mëngjesit, në banesën e tij në Allias, ai dyshohet se ka varur me armën e shërbimit bashkëshorten, 36 vjeçe. Materialet iu referuan për veprime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale "Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare", - thuhet në njoftimin e policisë. Ndërsa, burime për "GSH" pohuan se krimi ka ndodhur në banesën e çiftit, në dhomën e ndenjes. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, hetuesit e çështjes pohuan se krimi ka ndodhur pas një konflikti banal në çift, i cili ka degjeneruar deri në vrasje. Alket Arapaj, i cili akuzohet për veprën penale "Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare", ka qenë oficer në gradë prej 20 vitesh. Më parë

Gardisti vret bashkëshorten me armën e shërbimit: Dyshoja se më tradhtonte

Efektivi Alket Arapaj, praktikant i fesë, e qëllloi 36-vjeçaren me 3 plumba



36-vjeçarja e vrarë, Ervilma Seferaj



Gardisti 44-vjeçar, Alket Arapaj

PARALAJMËRIMI I VRASJES

Në një vështrim të parë në profilin e tij në "Facebook", 44-vjeçari Alket Arapaj e përshkruan veten si një njeri "të singërtë, këmbëngulës përtej durimit, i integruar tej mase, i thjeshtë e koklartë". Në fotot e shumta të tij mund të veçohet edhe një imazh, ku Arapaj shfaqet krahas bashkëshortes dhe vajzës së tyre. Pikërisht këtë imazh, autori i vrasjes së 36-vjeçares e përshkruan me fjalët: "Jeta ka edhe gjëra të çmura si familja". Ndërsa kishte bërë një status pikërisht për tradhtinë. "Tradhtia fodulle shkëlqen thjesht sa për një intermexxo edhe nëse është e hidhur shumë", shkruante gardisti.

ai ka qenë shoqëruar personatitësh dhe ka punuar në Presidencë. Ai prej disa vitesh ishte pozicionuar në njësi 3, të Pallatit i Brigadave. Kjo ishte martesë e dytë e gardistit.

DËSHMIA E GARDISTIT

Gjatë deklaratimeve paraprake përballë oficerëve të policisë, 44-vjeçari ka treguar se me bashkëshorten pati një debat para se të nisej për në punë. Arapaj ka rrëfyer se kishte nxjerrë armën në një moment gjaknxehtësie, pas dyshimeve se bashkëshortja e tradhtonte, duke qëlluar mbi të plot tri herë. Të njëjtat burime thanë se në disa nga deklaratat, 44-vjeçari ka qenë konfuz. Në rrethin shoqëror dhe familjar Arapaj njihet si person i sjellshëm dhe praktikues i fesë islame, ndërsa edhe gruaja e tij ishte e mbuluar. Çifti kishte një vajzë të vogël, të cilën e dërgonte bashkëshortja e vrarë çdo ditë në çerdhe, ndërsa ditët e fundit ajo nuk është parë nga fqinjët të dërgojë vajzën në çerdhe dhe mendohet se kishte filluar punë. Përveçse xhelozisë, dyshohet se vrasja ka

ndodhur pasi bashkëshorti nuk dëshironte që gruaja të fillonte punë, por të kujdesej për vajzën 3 vjeçe. Vajza është marrë nga prindërit e viktimës në një fshat të Tiranës pas ngjarjes.

FQINJËT

Vrasja e 36-vjeçares ka tronditur fqinjët e çiftit, të cilët dje deklaruan për "GSH" se familja nuk kishte probleme dhe ishin një model në lagje. Ajo ishin predikues të rregullt të fesë islame dhe gruaja ishte e mbuluar me shami. "Ishin shumë familje e mirë. Ai Alketi na fliste, ajo vajza ishte shumë e mirë. Nuk di, nuk di, ne kur morëm vesh tani në mëngjes, kemi ngulur pa mend. U ngritëm në 6, dëgjua pak zhurmë, por nuk na shkoi ndërmend gjë, nuk na shkante mendja kurrë. Unë kam 50 vjet që jetoj këtu që kur jam martuar dhe këta kanë vite që jetojnë këtu. E ëma, i ati ishin në Itali të djali tjetër dhe vinin në mars. Tani ka ndodhur kjo gjë... Ajo nusja dilte e mbushte ujë, ky djali shkante në punë i veshur. Kanë një vajzë 3 vjeçe", tha një fqinje.

Urdhri për punonjësit e policisë: Orët jashtë orarit kompensim me pushim, jo lekë

TIRANË - Punonjësit e Policisë së Shtetit që kanë punuar jashtë orarit nuk do të paguhen për orët shtesë. Për shkak të mungesës së fondëve, drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Ardi Veliu iu ka dërguar një letërporosi drejtorive vendore, ku iu shkruan që për orët shtesë të punës, punonjësit e policisë të shpërblehen me ditë pushim dhe jo me lekë. "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" kanë siguruar një kopje të kësaj letërporosie "Për përdorim me efikasitet të burimeve financiare në trajtimin e mbikohës së punës", e cila mban datën 1 shkurt 2019 dhe është e firmosur nga Ardi Veliu. Në shkresë thuhet se janë evidentuar problematika në disa njësi shpenzuese dhe në mungesë të fondeve në shumë struktura janë krijuar detyrime të mbartura,



të cilat shfaqen edhe në buxhetin e 2019-ës. Për këtë, drejtori i policisë ka porositur vartësit që punonjësit e policisë që kanë punuar jashtë orarit të kompensohen me ditë pushimi dhe vetëm në rastet kur kjo është e pamundur, të kompensohet me pagesë nga fondi i lirë ose fondi shtesë i policisë. Paga bëhet vetëm nëse shoqërohet me kërkesë me shkrim, ku argumentohet pse është e pam-

undur dhënia e pushimit. Kjo kërkesë më pas përcillet në Drejtorinë e Financave e shërbimeve mbështetëse në drejtorinë e përgjithshme. Në Policinë e Shtetit ka qenë gjithmonë problem kompensimi për orët shtesë të punës, për shkak të mungesës së fondëve. Kjo praktikë e re e urdhëruar nga Ardi Veliu e vështrëson edhe më tej përfitimin e kompensimit, veçanërisht në Drejtorinë e Policisë së Tiranës. Protestat e vazhdueshme në zonën e "Astirit", por edhe protestat disajavore të studentëve në fund të vitit 2018 bënë që për rreth 3 muaj, 6 komisarate në Tiranë të kalonin në gatishmëri, duke punuar jashtë orarit dhe pa asnjë pushim javor. Çdo efektivi i këtyre komisarateve ka shumë orë shtesë, por shumë pak gjasë që të paguhen për to.

Ministri Lleshaj vizitë blic në Malësinë e Madhe: Nuk po gjendet denoncuesi

U arrestua për ngacmim seksual, polici: Video është e imja, por jo për vajzën

Berhan Bajrakurti: E gjithë historia është trillim

SHKODËR

Videoja e shpërndarë në media është e imja, por nuk ka lidhje me asnjë të mitur dhe as me akuzat që janë bërë se është denoncuar nga nëna e të miturës". Kështu ka deklaruar punonjësi i policisë së Gruemirës në Malësinë e Madhe, Berhan Bajrakurti, i cili u arrestua dy ditë më parë për ngacmim seksual të një minoreneje. 53-vjeçari i shfaqur në momente intime të filmuar nga vetë ai, ka mohuar ta ketë përdorur këtë video për të shantazhuar një 15-vjeçare. Gjatë katër orëve të marra në pyetje, efektiv i policisë ka pranuar se video është e tij, ndërsa e ka quajtur trillim gjithë historinë. Ndërkohë që edhe për grupin hetimor mbetet enigmë se kush ka qenë denoncuesja, pasi si në komisariatet e Koplikut, si dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë së Shkodrës nuk ka të regjistruar ndonjë denoncim ndaj tij. Këtë e konfirmoi edhe ministri i Brendshëm, Sander Lleshaj, gjatë një vizite blic të bërë dje në Malësinë e Madhe.

HETIMET

Zyrtarë të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat nga Tirana kanë marrë në pyetje efektivin Bajrakurti, i cili ka mohuar t'i ketë dërguar video me përmbajtje seksuale vajzës së mitur. Por pavarësisht këtij pretendimi, Policia e Shtetit dhe prokuroria e Shkodrës kanë nisur hetimet. Efektiv i Policisë së Malësisë së Madhe, Berhan Bajrakurti rezultoi të jetë përjashtuar nga policia në vitin 2008. Gjatë kësaj kohe, ai ka punuar si fatori në autobusin e linjës Shkodër-Koplik. Burime nga Policia e Shtetit thonë se ai asnjëherë nuk ka qenë në pozicione drejtuese të paktën deri kur u lirua nga detyra. Përfshimi nga policia erdhi pasi u arrestua nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, pas dyshimeve se kishte futur sende të jashtëligjshme në dhomat e paraburgimit në policinë e Shkodrës.

Pas kësaj ai u arrestua si i dyshuar nga SHKB dhe qëndroi i ndaluar për pak kohë, por gjykata i dha pafajësinë, vendim që ai mund ta ketë përdorur për t'u rikthyer në radhët e policisë në vitin 2015. Gjatë kësaj kohe ka shërbyer në komisariatet e policisë së Malësisë së Madhe. Gjithashtu, mësohet se Bajrakurti ka qenë komisioner i Partisë Socialiste në Malësinë e Madhe në zgjedhjet lokale të 2015-s.

Inspektori Bajrakurti është i martuar dhe baba i 4 fëmijëve, tri vajza dhe një djalë. Të hënën, nëna e 15-vjeçares nga fshati Gruemirë denoncoi në media se 53-vjeçari e përndiqte prej



Punonjësi i policisë, Berhan Bajrakurti

ARRESTIMI PAS SKANDALIT

Policia e Shkodrës arrestoi dy ditë më parë efektivin Berhan Bajrakurti, pasi dyshohet se ka ngacmuar seksualisht një vajzë 15-vjeçare. Specialisti i policimit në komunitet në zonën Grumirë të Malësisë së Madhe, Bajrakurti, u denoncua nga nëna e 15-vjeçares, e cila ka thënë se shefi i policisë e ka marrë në makinë vajzën dhe ka kryer akte të turpshme. Gjithashtu, ai e ka telefonuar vajzën dhe ka kryer biseda erotike përmes telefonit. Në media u publikua një video, ku polici shfaqej i zhveshur duke komunikuar me videokamerë me 15-vjeçaren. Inspektori Bajrakurti është i martuar dhe baba i 4 fëmijëve, tri vajza dhe një djalë.

kohësh vajzën duke e telefonuar e duke u zhveshur përpara saj. Për të vërtetuar pretendimet e saj, nëna publikoi edhe një video ku Bajrakurti kryente veprime të turpshme në telefon.

VIZITA E LLESHAJIT NË MALËSINË E MADHE

Një ditë pas publikimit të një video-skandali ku ishte përfshirë shefi i policisë së Gruemirës, Behan Bajrakurti që ngacmonte një 15-vjeçare, ministri i Brendshëm, Sander Lleshaj ka shkruar mëngjesin e djeshëm në Malësinë e Madhe. Mësohet se Lleshaj shpërhohej në këtë vizitë blic nga kryetari i Bashkisë së Malësisë së Madhe, Tonin Marinaj dhe Drejtori i Policisë së Shkodrës, Vehbi Bushati. Gjatë kësaj vizite kreu i MB-së, nuk iu shmang dot pyetjeve të gazetarëve. Për rastin në fjalë ai tha se problemi më i madh që duhet zgjidhur për momentin është të gjendet denoncuesi, pasi nuk dihet kush është personi që ka bërë denon-

cimin për policin.

Keni thënë që fytyra e policëve do të jetë edhe fytyra juaj...kështu ju kemi dëg-



Ministri i Brendshëm Sander Lleshaj, dje në Shkodër

juar që nëse shihni policë që nuk sillen mirë atëherë ai do jem unë...

Lleshaj: Fytyra e policëve është fytyra ime dhe e juaja, e gjithë shoqërisë sonë. Policët na përfaqësojnë ne të gjithëve

Ju përfaqëson ai polic?
Lleshaj: Cili polic?

Policë për të cilin ka një videoskandal...

Lleshaj: Ai është një i arrestuar nga policia e shtetit, i arrestuar që mbrëmë.

Është thënë që i janë drejtuar komisariatit të Shkodrës dhe atij të Malësisë së

Madhe dhe nuk i është pranuar denoncim familjes...

Lleshaj: Kjo nuk është e vërtetë. Policia e Shtetit po kërkon që mbrëmë denoncuesin që nuk gjendet. Kjo është pyetja kryesore që duhet të keni ju dhe ne bashkë, kush është denoncuesi?

Pse mbahet i arrestuar kur nuk gjendet denoncuesi?

Lleshaj: Sepse duhet të parandalojmë çdo mundësi intimidimi të një denoncuesi potencial fakti që s'kemi është pyetja më e madhe që do ta sqarojmë shpejt.

Ngacmoi studenten e Juridikut, arrestohet efektiv i FNSH-së

SHKODËR - Ish-kryeministri Sali Berisha ka publikuar dje denoncimin e një studenti që flet për një rast tentative përdhunimi në dyert e Universitetit të Shkodrës. Denoncuesi thotë se një punonjës policie, efektiv i FNSH-së i veshur civil ka ngacmuar vajzat e fakultetit Juridik dhe njëherën ka tentuar ta përdhunojë, por është kapur në kohë nga studentët që e kanë mbyllur në banjë. Gjithsesi, sipas studentit polici nuk është arrestuar. Vetëm pak minuta pas publikimit të denoncimit, mësohet se efektiv i policisë i forcave të FNSH-së është marrë në pyetje nga SHCBA dhe është prangosur. Burime nga policia e Shkodrës bënë me dije për "GSH" se efektiv ka dhënë deklaratën e tij për rastin, duke mohuar se ka tentuar të dhunojë apo abuzojë me studenten. Sipas të njëjtave burime, efektiv i FNSH-së ka deklaruar se e pëlqente vajzën, studente e juridikut dhe ia ka shprehur këtë gjë. Por kur ajo e ka refuzuar e ka kapur për krahu dhe vajza është trembur për shkak të armës së shërbimit që mbante ai. Mësohet se bëhet fjalë për një punonjës policie të moshës rreth 25-26 vjeç. Ndërkaq, mësohet se për një moment efektiv është futur në tualetin e shkollës, dhe në mbështetje të shqesë së tyre, disa studentët djem kanë mbyllur derën e tualetit, duke e lënë brenda policin. I gjendur në një situatë të tillë, efektiv ka thyer me forcë derën e tualetit dhe ka dalë, por në atë moment studentët kanë parë të mbante në brez edhe një armë. Ata kanë njoftuar menjëherë policinë, e cila ka arrestuar efektivin e Forcave të Ndërhijës së Shpejtë.

Skandali, Salianji: Ka një mori video të tjera të neveritshme, polici i regjistronte për shantazh



dhjetëra gra të tjera!

Shumë prej tyre e kanë denoncuar në komisariat, por policia i ka shpërfillur

dhe nuk ka marrë asnjë herë denoncimet e tyre. Pavarësisht se mostra i regjistronte madje edhe me video për

t'i shantazhuar apo për nevojë denigruese të tij. Sot ekzistojnë prova dhe video që viktimit i denoncin në polici. Këto video i disponon Policia e Shtetit! Disa prova dhe video më kanë ardhur në inbox nga punonjës policie dhe janë neveritëse po aq sa mosreagimi i shtetit në raste të tilla. Kam vendosur të mos i publikoj videot, sepse vetëm i shtojnë shëmti videos që tashmë është publike. Por policia dhe organet ligjzbatuese që i kanë, duhet t'i dënojnë me ashpërsinë më të madhe ligjore përgjegjësi e mosveprimi po aq sa vetë dhunesin!

EMIGRIMI NË ITALI PROJEKTET E REJA

Drejtoresha e INAS: Përfitojnë fëmijët, bashkëshortët dhe prindërit e shtetasve të huaj

Valtiza Duro

Bashkimi familjar në Itali, Aliaj: Projekti FORMA, lehtëson procedurën

"Trajnime të shumta para nisjes dhe ndihmë për dokumentacionin"

Të gjithë shqiptarët që janë të interesuar të realizojnë bashkim familjar në Itali, tashmë mund të zgjedhin një rrugë më të lehtë dhe më të shpejtë duke u bërë pjesë e projektit FORMA. Përfutjes të këtij projekti janë fëmijët, bashkëshortët dhe prindërit e shtetasve të huaj që kanë aplikuar për bashkim familjar, ku përfshihet edhe vendi ynë. Drejtoresha e patronatit INAS Albania, Beskida Aliaj, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" tregon se "FORMA" është rruga e bashkimit familjar për në Itali. Ajo bën me dije se pjesëmarrja e përfutjesve në aktivitetet e propozuara paraqet një mundësi të çmuar për të marrë ndihmë të drejtpërdrejtë në menaxhimin e dokumenteve dhe procedurave të nevojshme për hyrjen në Itali; e për të fituar aftësi qytetare dhe gjuhësore.

Çfarë është projekti Forma dhe cili është synimi kryesor i tij?

Projekti FORMA financohet nga "Fondi për Azilin, Migracionin dhe Integrimin", nëpërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale. Për zbatimin e këtij projekti janë angazhuar 4 patronatet CePa (INCA, INAS, ITAL dhe Patronato ACLI), me INCA CGIL si partner kryesor dhe me partneritetin e SHOQATËS GJENERATA E RE ITALO-KINEZE, ANOLE, UNIRAMA S.A.S. dhe Shkollës Ndërkombëtare të Gjuhës. Projekti synon të kualifikojë dhe të lehtësojë rrugën e bashkimit familjar për fëmijët, bashkëshortët dhe prindërit e shtetasve që kanë aplikuar për këtë procedurë.

Mund të na përmendni disa prej shërbimeve që ofron projekti?

FORMA vë në dispozicion të përfutjesve një sistem shërbimesh duke i kushtuar një vëmendje të veçantë çështjeve të tilla si: njohja e gjuhës italiane; njohja e kulturës qytetare; studiumit të trashëgimisë kulturore dhe vlerave të Italisë. Është parashikuar orientimi fillestar për të vlerësuar kompetencat, aftësitë dhe qëndrimet e përgjithshme të subjekteve të përfshira; asistencë në menaxhimin e dokumentacionit në lidhje me procedurat e hyrjes; trajnimi i gjuhës; edukimi



Drejtoresha e patronatit INAS Albania, Beskida Aliaj

KATEGORIË PËRFITUESE:

1. Bashkëshortë jo të ndarë ligjrisht, me moshë jo më pak se 18 vjeç;
 2. Fëmijë të mitur, qoftë edhe të bashkëshortit apo të lindur jashtë martese, të pamartuar me kusht që prindit tjetër, nëse ekziston, të ketë dhënë pëlqimin e tij;
 3. Fëmijë në moshë madhore në ngarkim, në rast se për arsye objektive nuk janë në gjendje të kujdesen për nevojat e tyre të jetesës për shkak të gjendjes shëndetësore që përbën invaliditet të plotë;
 4. Prindër në ngarkim, në rast se nuk kanë fëmijë të tjerë në vendin e origjinës apo prejardhjes;
 5. Prindër mbi 65 vjeç që nuk kanë fëmijë të tjerë në vendin e origjinës apo prejardhjes (ose kur fëmijët e tjerë nuk kanë mundësi të kujdesen për ta për arsye të rënda shëndetësore të dokumentuara).
- Aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga projekti FORMA përfshijnë:**
- vënien në dispozicion të hapësirave dhe materialeve të informacionit, duke iu referuar veçanërisht procedurave të aplikimit për vizë, të legjislacionit të përgjithshëm në fushën e të drejtave sociale dhe vlerave që udhëzojnë sjelljet në vendin tone;
 - shërbimet e informacionit, asistencë, orientim dhe trajnim përpara nisjes së tyre në postet;
 - orientimi fillestar për të vlerësuar kompetencat, aftësitë dhe qëndrimet e përgjithshme të subjekteve të përfshira;
 - asistencë në menaxhimin e dokumentacionit në lidhje me procedurat e hyrjes;
 - trajnimi i gjuhës;
 - edukimi qytetar-kulturor;
 - organizimi i laboratorëve dhe seminareve për studim më të thellë të temave të trajtuara.
 - akses në një platformë online informacioni dhe trajnimi në distancë, i cili lejon përmirësimin e përdorimit dhe përshtatjen e përbajtjes së propozuar.

qytetar-kulturor; organizimi i laboratorëve dhe seminareve për studim më të thellë të temave të trajtuara; si edhe akses në një platformë online informacioni dhe trajnimi në distancë, i cili lejon përmirësimin e përdorimit dhe përshtatjen e përbajtjes së propozuar.

A ofrohet mbështetje individuale nga ana juaj për individët që dëshirojnë të bëjnë bashkim familjar në Itali?

Bazuar në nevojat e përfutjesve, është parashikuar edhe mbështetje individuale, si për shembull ofrimi i shërbimeve të lartpërmendura në shtëpi. Në Shqipëri janë dy patronatet që po kujdesen për zbatimin e aktivitetit të veçantë dhe realizimin e projektit në tërësi; bëhet fjalë specifiku për Patronato ACLI dhe Patronato INAS. Projekti FORMA parashikon mbështetje për të gjithë ata qytetarë shqiptarë, në pritje apo të pagjisur me një "Nulla Osta" nga autoritetet përkatëse në Itali, të cilët duhet të paragesin një kërkesë për vizë për bashkim familjar pranë autoriteteve konsullore italiane, qoftë në Tiranë apo në Vlorë, sipas përkatësisë geografike.

Por pse të interesuarit duhet të përfshihen pikërisht në projektin FORMA për të realizuar bashkim

TAKIMET

Kemi takuar grupmosha të ndryshme dhe realizuar bashkime familjesh, duke përvetësuar përvoja që jemi të gatshëm t'ua vëmë në dispozicion të gjithë të interesuarve për këtë praktikë, duke ruajtur si gjithmonë mënyrën tonë të punuarit me shërbime "falas". Të gjithë të interesuarit mund të paraqiten pranë patronatit INAS ALBANIA apo PATRONATO ACLI TIRANA

Si realizohet mësimi i gjuhës italiane nëpërmjet këtij projekti?

Mësimi i gjuhës italiane realizohet duke ndjekur një kurs të strukturuar, i cili zhvillohet përmes një aplikacioni funksional shumëgjuhësh ku përmblotja e propozuar do të përshtatet në bazë të gjuhës mëmë të përdoruesit. Kjo gjë do të bëjë të mundur arrijten progresive të nivelit A1 dhe A2, në përputhje me dispozitat e Kornizës së përbashkët Evropiane e referencës për gjuhët (CEFR).

Çfarë duhet të bëjnë familjarët që i bashkohen aplikantit?

Ata duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në shërbimet dhe iniciativat e planifikuara; si dhe të përdorin platformën e mësimin në distancë që do të vihet në dispozicion për përvetësimin e aftësive qytetaro-gjuhësore.

Sa i vlefshëm ka rezultat ky projekt për bashkimet familjare në Itali?

U bë një vit tashmë nga takimet e para me përfutjesit e këtij projekti dhe të dyja zyrat që po punojnë për realizimin e tij ndajnë të njëjtin mendim: një rrugëtim plot sfida që na ka lejuar të dyja palëve të ndajmë përvoja njerëzore dhe të jemi pjesë e pengesave dhe kapërcimeve të situatave nga më të ndryshme. Kemi takuar grupmosha të ndryshme dhe realizuar bashkime familjesh, duke përvetësuar përvoja që jemi të gatshëm t'ua vëmë në dispozicion të gjithë të interesuarve për këtë praktikë, duke ruajtur si gjithmonë mënyrën tonë të punuarit me shërbime "falas". Të gjithë të interesuarit mund të paraqiten pranë patronatit INAS ALBANIA apo PATRONATO ACLI TIRANA dhe të flasin me mua personalisht apo me Alma Begiri-n. Ata mund të na shkruajnë edhe në adresat e emailit tirana@patronato.acli.it dhe b.aliaj@inas.it, apo të na kontaktojnë në numrat 00355/675383700 dhe 00355/683448188.

Rreth 11 mijë biznese janë të lira të deklarojnë zero fitim

Platforma e PD, Ahmetaj: Dyfishon taksat për 300 mijë të punësuar

Për rrogat nën 1 mln lekë në muaj, taksa dyfishohet

Ish-ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, deklaroi se në platformën e Partisë Demokratike parashikohet rikthimi i taksës së sheshtë, që sipas tij do të thotë dyfishim i taksës aktuale. "Diskutimi ekonomik që i intereson, i dhemb, apo u shkon në shtëpi qytetarëve është e rëndësishme të bëhet transparent. Cilat janë shtyllat e paketës? E para, është rikthimi te taksa e sheshtë. Për çdo të punësuar në Republikën e Shqipërisë që ka një pagë nën 1 mln lekë në muaj, taksa dyfishohet. Unë në shkrim kam sjellë shembuj konkretë se çfarë ndodh në pagën e një infermiere. Taksa e sheshtë do të thotë se 300 mijë të punësuar do të pësojnë një rritje të konsiderueshme takse nga 9 herë deri në dyfish, pra deri në dy herë dhe e gjithë gama e të punësuarve është 40% e të punësuarve. Shuma që këtyre familjeve iu ngarkohet në kurriz është 5.6 mld lekë, rreth 50 milionë dollarë dhe pothuajse e njëjta shumë u hiqet vetëm 5% të punësuarve", tha kreu i Komisionit të Ekonomisë. Deklarata u bë dje në studion e "News 24" në rubrikën "Opinion". Ahmetaj analizon shtyllat e paketës së PD-së dhe për të ilustruar rritjen e taksave tha se një infermier nga 2 mijë e 23 lekë të reja, do paguaje rreth 4 mijë e 100 lekë taksa. Sipas Ahmetajt, kjo forcë politike po vjen me një instrument fiskal që godet pjesën më të madhe të popullsisë. "Më thuaj pse do jetë një infermier, një mësues, një i punësuar në sektorin privat të shtunë në protestë. Pse? Që të mbështesë një alternativë që i rrit dyfish taksat? Një infermier, sot paguan 2 mijë e 23 lekë të reja, do paguaje 41 mijë lekë të vjetra. Pra, dyfishimi i taksës", tha Ahmetaj.

BIZNESET

Ish-ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, komentoi platformën ekonomike të PD-së. Ahmetaj tha se me planin ekonomik të PD-së do të shohet jo vetëm deficit i vendit, por edhe do të promovohet oligarkia. "Janë 93 mijë biznese. Pse duhet të votojmë një parti tjetër që na vë taksat të reja? Po, janë rreth 11 mijë biznese, por janë të lira të deklarojnë 0 fitim. Më falni për zhargonin që është për t'ia futur vetes, ka edhe një shtyllë të tretë, që varros të gjithë vendin. Thonë që ne do të ulim kontributin e sigurimeve shoqërore. E dini ju që të gjithë ata që paguaje taksat financojnë buxhetin që paguajmë brezin e tretë. Me këtë lëvizje që paralajmëron PD-ja do të thotë që të shohet deficit i buxhetit të vendit tonë. Nëpërmjet tatimit 7%, e di sa biznese ndihmohen? Nëpërmjet kësaj pakete promovohet oligarkia. 137 milionë dol-



Ish-ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

larë iu duken si detaje, janë gur shkëmb për qytetarët e vendit, e sigurt drejt kolapsit ekonomik. Thënë kjo, e gjithë platforma është shkatërruese për detajet. Më në fund e ka pranuar edhe FMN-ja që taksa progresive ka ndihmuar në uljen e parazisë në Shqipëri. Nuk po them që Shqipëria është vend i pasur, por është ndryshe nga lugina e errët e 2013-ës. Unë e theksova se realiteti në Shqipëri nuk është rozë. Tani çfarë është

ndryshe, Shqipëria nuk e ka më borxhin 74%, por e ka neto. 260 mijë të punësuar është përmirësim? Patjetër që është përmirësim. Rritja ekonomike nga 1% statistiki është në 4.2%, aty e kemi bazën e përmirësimit qoftë të tryezës së bukës, qoftë të investimeve, qoftë të përmirësimeve, po shkon 1 miliard euro, në shifra rekord. Tani të vijmë te perceptimi, që nuk përputhet me realitetin se brezat kanë perceptimet e tyre", u shpreh ai.

Fotoja me Salianjin, ish-ministri tregon çfarë ndodhi: Doja ta "helmoja"

Shumëkujt i ka ngjallur shabi sot një foto që ka qarkulluar në rrjetet sociale, ku shfaqet deputeti demokrat, Ervin Salianji dhe ish-ministri i Financave, Arben Ahmetaj. Çudi për faktin se Salianji ka qenë një deputet shumë aktiv, duke sulmuar gjithmonë mazhorancën, ndërkohë që në kafe biseda me tyre duket shumë normale. Pikërisht këtë takim e ka sqaruar ish-ministri Ahmetaj, i cili tha me shaka fillimisht se donte ta "helmonte" Salianjin, por se nuk e zuri helm. Ndërsa më pas tha se takimi ishte një rastësi. Nuk do pyes se çfarë dyshimesh ngjall? Po bënim komplot kundër PD apo... E kisha ftuar zotin Salianjin për kafe që ta "helmoja", i kam hedhur edhe helm në kafe, por më rezultoi që nuk e ka kapur helm", tha Ahmetaj. Përshtypje nuk duhet t'i bëjë kujt, sepse këtu ulet kryeministri me kryetarin e opozitës. Nuk e



kam mik, është një 3-minutësh i rastësishëm. Është një gazetar, miku im. Më ka dhënë leje që t'ia përdor emrin, është Ed Manushi. Dhe Ed manushi me çfarë kuptoj janë miq me Salianjin. Unë rastisa në një drekë miqsh me punonjës të Kryeministrit dhe me një botuese dhe në një

moment rastësisht u përqaamë, pasi unë u ula me Edin, zoti Salianji erdhi dhe mirë bëri që erdhi. As ai, as unë nuk jemi vulgarë. Është një rastësi që as s'duhet trajtuar si çudi, por të thashë, doja ta "helmoja" dhe nuk e kapi helm", tha Ahmetaj.

Familjet, më shumë kredi në lekë

Huamarrja, 62.7% e portofolit është në monedhën vendëse

Kreditimi i individëve po orientohet gjithnjë e më shumë drejt lekut. Sipas Bankës së Shqipërisë, në dhjetor 2018, kredia në lekë përbënte 62.7% të totalit të kredisë për individë. Krahasuar me një vit më parë, pesha specifike e kredisë në lekë është rritur me 3.5 pikë përqindje. Kredia në lekë për segmentin e individëve u rrit me mbi 10% për vitin e kaluar, ndërsa ajo në valutë me më pak se 3%. Normat e ulëta të interesit të kredisë për individë, si dhe politikat e ndjekura nga bankat prej disa vitesh për kreditimin e individëve në monedhën në të cilën kanë të ardhurat, mendohet se janë faktorët kryesorë që po e mbështesin këtë zhvendosje. Rritja e kredisë në lekë, të paktën tek individët, është një nga rezul-



tatet më të prekshme të politikës monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë. Arsyeja kryesore që i ka shtyrë individët drejt huamarrjes në valutë në të shkuarën ka qenë çmimi më i lirë i kredisë. Por, ngushtimi i ndjeshëm i diferencave të interesave ka bërë që indi-

vidët të mos kenë stimul domethënës për ta marrë kreditin në një monedhë tjetër nga ajo e të ardhurave. Në fund të vitit të kaluar, diferenca në interesin mesatar mes kredive në euro dhe atyre në lekë për individët ishte rreth 0.5 pikë përqindje.

Ulja e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në 6%

Industria ushqimore: Po goditemi nga ndryshimi i TVSH-së

Ulja e rimbursimit të TVSH-së për fermerët nga 20% në 6% kundërshtohet nga prodhuesit dhe tregtarët. Ata thonë se ndryshimet që janë bërë në paketën e re fiskale të 2019-ës ndihmojnë importuesit dhe dëmtojnë prodhimin vendës. Sipas tregtarëve, lëndën e parë ata e blejnë me një TVSH 6%, por e shesin me 20% TVSH. Kjo kosto e shtuar prej 14% sipas tyre dëmton sektorin. "Kanë vendosur një taksë mbi produktin vendës, sepse TVSH është të paguash mbi vlerën që i shton produktit. Ne gjendemi në një situatë që edhe sikur produktin ta shesim pa asnjë lloj marzhi, paguajmë 14% dhe kjo ndikon shumë në çmimet e shitjes apo në çmimin e blerjes. Pra, do të jemi përballë fermerëve që të ulim çmimin apo të rrisim çmimet e shitjeve në treg", - thotë përfaqësuesi i industrisë ushqimore. Nga përlogaritjet e kryera, kostoja vjetore e kësaj takse të re për prodhimin primar bujqësor vendës arrin në 100 milionë euro në vit. Prodhuesit i kërkojnë qeverisë barazimin e nivelit të TVSH-së me 6% si në shitje, edhe në blerje me argumentin e uljes së kostove për qytetarët dhe harmonizimin me legjislacionin fiskal të vendeve europiane. Prodhuesit thonë se shqetësimet ia kanë paraqitur si Ministrisë së Financave, ashtu edhe Ministrisë së Bujqësisë, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje.



Autoriteti Rrugor Shqiptar ka njoftuar së fundmi mbi gjendjen e akteve kombëtare, duke vënë në gatishmëri të gjithë kontraktorët për pastrimin dhe shpërndarjen e kripës në segmentet ku ka prezencë dëbore. Në qarkun e Korçës dhe në rajonin jugor Gjirokastrë ka pasur reshje shiu dhe në lartësi mbi 1300 m, ka pasur reshje dëbore. Megjithatë, në të gjitha akset e këtij rajoni qarkullohen normalisht. Në rajonin qendror Tiranë ka pasur reshje shiu, ndërsa në akset e Dajtit ka pasur reshje të dobëta dëbore.



Reshje shiu e dëbore në zonat malore

ARRSH: Vijon pastrimi i rrugëve. Akset ku qarkullohet me zinxhirë

Deri tani ARRSH ka njoftuar se nuk ka probleme për qarkullimin. Në Librazhd-Steblevë, ka pasur rreth 20 cm borë dhe po vazhdon puna për pastrimin dhe shpërndarjen e kripës. Të gjitha akset e këtij rajoni qarkullohen normalisht. Në rajonin verior Shkodër ka pasur reshje shiu dhe dëborë gjatë gjithë natës. Trashësia e dëborës ka sh-

kuar nga 10-40 cm. Edhe në këtë zonë kontraktorët po vazhdojnë punën për pastrimin e akteve dhe shpërndarjen e kripës. ARRSH lajmëron se rrugët në të cilat duhet të përdoren zinxhirët janë: Ura e Cerenecit-Steblevë, 25 km e fundit, në të cilën ka pasur rreth 20 cm dëborë, Trebisht-Doganë, ku ka pasur rreth 5-10 cm dëborë, Qafë Bualli-

Krastë, ka rreth 20 cm dëborë dhe Kuben-Vasie, ku dëbora ka arritur në 40 cm. Sipas ARRSH, të gjitha akset e tjera qarkullohen pa probleme. ARRSH ka rekomanduar të gjithë përdoruesit e rrugës të bëjnë kujdes në lëvizje dhe të respektojnë sinjalistikën rrugore, të reduktojnë shpejtësinë për shkak të lagështisë në rrugë.

Ministrja Balluku, në dëgjese: Do gjejmë zgjidhjen më të arsyeshme për shqetësimet tuaja

Vendimi për makinat e vjetra, tregtarët: U dëmtuam ekonomikisht

Kërkesa, targimi i gjithë flotës po dëmton bizneset

Tregtarët që importojnë makina të pordura janë ankuar se vendimi që i detyron që të targojnë të gjitha mjetet që janë futur në vend i vë ata në vështirësi ekonomike. Në një takim me ministrën e Infrastruktursë dhe Energjisë, Belinda Balluku, tregtarët u shprehën se targimi mund të bëhet vetëm në momentin që ata shesin mjetin, në të kundërt targimi i të gjithë flotës ka kosto të lartë dhe do t'i bllokonte në aktivitetin e tyre. Si shembull ata sollën rastin nëse shoqëria falimenton çka bën që targimi i gjithë mjeteve të jetë një shpenzim më tepër që rëndon situatën e tyre. Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë, Balluku, theksoi se gjatë këtyre ditëve do të ketë diskutime mes institucioneve të varësishme të përfshira në proces, por edhe tregtarëve për të gjetur një zgjidhje sa më të përshtatshme. Vendimi që ndalon importin e mjeteve me vjetërsi më shumë se 10 vjet u lë kohë tregtarëve që të targojnë mjetet që janë tashmë në Shqipëri, por edhe pa targa, deri në 1 mars që të plotësojnë këtë hallkë. Balluku tha se ka një sërë masash dhe lehtësimesh që janë bërë lidhur me sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, që lehtësojnë burokracinë për bizneset dhe qytetarët.



Ministrja e Infrastruktursë dhe Energjisë, Belinda Balluku gjatë takimit me tregtarët

VENDIMI

Vendimi që ndalon importin e mjeteve me vjetërsi më shumë se 10 vjet u lë kohë tregtarëve që të targojnë mjetet që janë tashmë në Shqipëri, por edhe pa targa, deri në 1 mars që të plotësojnë këtë hallkë.

hapësirave kohore për importin e makinave të vjetra dhe me interes historik, si dhe zgjatjen e afatit për kryerjen e procedurave të nevojshme për regjistrimin e tyre. Megjithatë, ministrja ka premtuar se MIE do të shqyrtojë me kujdes të gjithë problematikën e krijuar si dhe kërkesat e paraqitura nga grupet e interesit, për të gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme si për tregtarët e automjeteve, ashtu edhe për të shmangur ndotjen e mjedisit. "Kjo është një dëgjese për të përmirësuar një fushë në të cilën disi ju

janë prekur interesat tuaja dhe ne do gjejmë një rrugë të mesme, sa më të mirë, për të qenë konform kërkesave dhe ligjeve që kanë të bëjnë me mjedisin, por nga ana tjetër pa ju prishur edhe juve bizneset në të cilat keni investuar", është shprehur Balluku. Përfaqësuesit e biznesit nga ana e tyre kanë falënderuar për vëmendjen e treguar nga MIE si dhe për gatishmërinë e treguar për të gjetur një zgjidhje të shqetësimeve të tyre.

Të dhënat zyrtare tregtojnë se në nëntor tregtarët

nxituan të importonin automjete të përdorura te nevojave të tregut, teksa importi i tyre arriti në 7,731, nivel rekord. Edhe në tetor, kur ishte dhënë tashmë lajmi për masën që synonte uljen e ndotjes në mjedis, u importuan gati 5 mijë automjete të vjetra. Në total, gjatë gjithë vitit 2018 janë importuar rreth 50 mijë mjete të përdorura, me një rritje prej 11% në raport me vitin e mëparshëm. Ky është niveli më i lartë që nga 2012-2013, kohë kur u konstatua rritje e importit të mjeteve të përdorura, pas heqjes së detyrimeve doganore. Në fund të shtatorit 2018 kishin rreth 56 mijë automjete stok në vend, që llogaritet si diferenca mes mjeteve që janë importuar dhe atyre që

janë regjistruar, sipas të dhënave nga Doganat dhe Drejtoria e Transportit Rrugor. Këtyre u shtohen edhe të paktën rreth 10 mijë mjete të importuara në tetor-nëntor.

LIGJI

Nga 2 dhjetori 2018 ka hyrë në fuqi vendimi i Këshillit të Ministrave, që ndalon importin e automjeteve që janë të përdorura më shumë se 10 vjet, duke ndikuar mesatarisht 80% të totalit të importeve vjetore. Mjetet e reja që do të hyjnë duhet të përmbushin normën Euro 5, si për makinat ashtu dhe kamionët, ndërsa autoveturat e përdorura, që përmbushin normën Euro 4, duhet të jenë prodhuar jo më shumë se 10 vjet para datës së regjistrimit të parë në Shqipëri.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Realizimi i lidhjes online ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë për një periudhë tre vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 9,720,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkeese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Realizimi i lidhjes online ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë për një periudhë tre vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 07 Mars 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



Programme: Sustainable Development of the Rural Areas

Agriculture and rural development are of crucial with regard to socio-economic development in Albania as it accounts for 23% of the GDP and 42% of the overall employment. The majority of agri-cultural holdings is characterized by fragmented land use and small stock sizes. Significant structural deficits exist as well as weak advisory services and representation structures. In view of the aspired EU accession, a large proportion of farms and smaller processors are not sufficiently competitive. The consolidation of agriculture in the context of EU common agricultural policy and the current situation in rural areas require that the rural population has alternative income and employment opportunities. This is especially true for women and young people. Young people in particular leave the rural regions temporarily or completely in search of more attractive income opportunities. The strongest growth and employment impulses come from rural tourism. The further development of sustainable rural tourism depends heavily on the protection of natural and cultural landscapes and the sustainable exploitation of natural resources in rural areas. The environmental, economic and social potentials in rural areas are not yet sufficiently exploited to sustainably create and sustain diversified income and employment perspectives.

Starting in January 2019, a new BMZ-funded program on rural development will promote income opportunities in rural areas through increased competitiveness and diversification of agriculture, the valorization of biodiversity and the potential of rural tourism for employment-generating activities. The program will contribute to employment promotion in the agricultural sector and non-agricultural activities in rural areas by focusing on the principles and instruments of the EU's common agricultural policy for rural development. It promotes the participation of young people and women and thus contributes to gender equality. The program will apply an integrated approach on rural development with a focus on agriculture and rural tourism. It will consist of three interrelated fields of intervention (outputs):

- Output 1) Policy Advice for Rural Development
- Output 2) Promotion of Selected Value Chains (Cluster I: Tourism; Cluster II: Agriculture)
- Output 3) Improvement of Education & Training in Agriculture & Rural Tourism
- Output 4) Support to Agricultural Knowledge and Innovation System

The programme's duration is foreseen from 01/2019 – 12/2022.

The programme's target groups focus on young people and returning migrants. In total 5 of the programme's 10 Mio. EUR are coming from the fund for returning migrants (Perspektive Heimat)

"Sustainable Development of the Rural Areas" programme, seeks the following staff:
Advisor - Communication and Outreach

A. Responsibilities

The candidate is responsible for:

- Development and implementation of a communication and outreach strategy for the programme for its activities in agriculture, diversification and rural tourism
- Monitoring and reporting the programme's results in the context of the returning migrants (reporting on indicators and storytelling)
- Identifying digitalization needs for internal project management and for the service delivery of the programme; designing and coordination measures regarding digitalization
- Supporting the development stakeholder networks in the programme's fields of intervention in close cooperation with relevant advisors.
- Innovation and knowledge management;
- Maintaining of a good flow of communication and information between all involved institutions and counterparts and GIZ including regional and global projects

B. Tasks

1. Communication & Outreach

The candidate

- Develops a communication strategy of the programme in close cooperation with the pro-programme manager and the team (this involves use of social media, development of PR materials, events etc.)
- Coordinates the implementation of the communication strategy
- Identifies digitalization needs of the programme;
- Ainstreams digitalization requirements of GIZ HQ and GIZ Office Albania;
- Advises the team on digital tools and innovation for internal use as well as service delivery in the programme's fields of intervention
- Conducts knowledge management in the field of digitalization vis-à-vis GIZ Albania and GIZ HQ if needed

2. Outreach & Networking

The candidate

- Supports the technical advisors in agriculture and rural tourism to facilitate the establishment of networks of their respective target groups and key stakeholders (farmers, tourism service providers, returnees etc.)
- Facilitates the exchange of knowledge, lessons learnt, good practices and innovation between key stakeholders and networks relevant for the programme
- Participates in relevant GIZ groups (Fachverbund, Communities of Practice, IDA groups, GIZ Albania groups)

3. Monitoring Perspektive Heimat

- Identifies monitoring and reporting needs regarding the returnee funds
- Coordinates monitoring of respective indicators and prepares storytelling and PR measures according to needs.
- Liaison to monitoring staff of other relevant projects (esp. PROSEED and PME) and respective focal persons in HQ
- Mainstreams updates and information with regard to migration issues from HQ and from Albania

C. Required qualifications, competences and experience:

Qualifications

- university degree in social sciences or communication
- 3-5 years' professional experience in communication management or related fields
- Interest in rural development and employment issues
- professional knowledge on digitalization issues and tools
- professional experience in communication and outreach activities
- basic knowledge of issues related to returning migrants and the BMZ programme "Perspektive Heimat"
- professional experience with working with young people, private sector actors and returning migrants is desired but not a precondition
- knowledge of German language (reading, speaking and writing) is essential for this position and a precondition for the candidate's selection
- confident and professional appearance towards different hierarchy levels of project partners
- strong organisational competence
- strong desire and ability to work in a team
- willingness to travel within Albania regularly
- very good knowledge of English as working language of the programme
- willingness to upskill as required by the tasks to be performed – corresponding measures are agreed with management

Contract conditions:

- Full time Employment
- Programme office in Tirana
- Assignment period: asap until 31.12.2022

Please forward your application until **24th of February 2019**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

Please note that the interview will be partly conducted in German language!

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

SHPF in Albania is looking for a dynamic Executive Director with 5 years of relevant work experience. Under the overall supervision of Board of Directors and the President of the Association, the Executive Director is responsible for the day-to-day management of the SHPF activities, services, including all substantive and administrative matters. The position will be based in Tirana and be offered a full time assignment.

Duties & Responsibilities

- Manage and coordinate day-to-day SHPF activities, from substantive, administrative and financial points of view
- Ensure a good relationship with the SHPF Board members by supporting their operations. Responsible for implementing Board's strategic agenda and policies. Organize and facilitate regular Board of Directors' meetings
- Actively maintain existing members and seek out new members
- Ensure timely preparation and compilation of the SHPF Annual/Quarterly Work Plans and their submission to the Board as appropriate
- Prepare monthly reports for the Board on the SHPF key activities, issues and required action points. Prepare annual/semi-annual progress and financial reports and submit them to SHPF Board as appropriate. Ensures Committee's output is delivered according to organization's policies.
- Provide direction and leadership in advocating the SHPF objectives, in ensuring that all interested parties are well informed about the SHPF activities and goals
- Represent SHPF as required in Albania and build professional relationships with national and regional health care authorities and relevant national and international partners to ensure the full participation of a broad spectrum of national leadership in the identification, planning and execution of SHPF activities
- Serve as media contact in order to enhance SHPF image
- Advocate the interests of the members in improving the pharmaceutical business climate in Albania
- Maintain relationships with the Government of Albania and EFPIA

Required Qualifications/Competencies

- 5 years of relevant working experience.
- A Minimum of University Degree
- Strong managerial skills, ability to work in a dynamic and multipurpose environment.
- Highly developed leadership skills including the ability to inspire, encourage and build trust and confidence. Proven experience working in service to a broad range of clients and stakeholders
- In depth knowledge of the pharmaceutical market and dynamics. Solid understanding of the issues facing countries in economic transition
- Excellent communication skills both written and oral in both English and Albanian (conversant). Proven ability to draft, edit and produce written proposals and results-focused reports
- Proven experience working with Government, civil society, international organizations and donors
- Experience in the usage of computers and office software packages (MS Word, Excel, etc.)
- Familiarity with social media
- Strong and documented management skills and experience. He/she should be able to set clear standards for accountability, probity, value for money and risk management; to ensure sound and transparent financial management; and deliver continuing improvement in the SHPF effectiveness and in its systems to measure and report on this
- The ability to think beyond traditional modes and to be innovative in seeking solutions to complex operational and logistical challenges
- Ability to fulfill SHPF responsibility of accountability and transparency to members of the Board and other stakeholders
- Strong advocacy skills to be utilized in extensive public speaking, media interviews and interaction, giving testimony to intergovernmental bodies, and advocating for SHPF

The application deadline for this position is 27 February 2019

Please submit a CV and a cover letter, stating your motivation for applying and why you believe you are qualified for the position, to info.shpf@gmail.com

Only successful candidates will be contacted.



BRITISH AMERICAN TOBACCO

British American Tobacco Albania sh.p.k.

Njofton se duke filluar nga data 5 Shkurt 2019, cmimet maksimale të shitjes me pakicë për produktet e saj të duhanit do të jenë si vijon:

Nr	MARKA	Çmimi maksimal/paketë i shitjes me pakicë
1	Kent Nanotek (Infina)	320
2	Kent HD Neo	320
3	Kent HD Infina	320
4	Lucky Strike NFF King Size 6 mg	250
5	Lucky Strike NFF Demislims 6 mg	230
6	Lucky Strike NFF King Size 4 mg	250
7	Rothmans Leggera	250
8	Rothmans of London (Blue)	220
9	Rothmans of London (Sky Blue)	220
10	Lucky Strike NFF Demislims 4 mg	230
11	Dunhill FC 7 mg	330
12	Dunhill FC 4 mg	330
13	Rothmans of London Demi 6mg	220
14	Rothmans of London Demi 4mg	220
15	Lucky Strike Double Capsule Wild	250
16	Eva Slims	200

**Çmimet shprehen në Lek*

Njoftimi i mësipërm bëhet në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar".

British American Tobacco Albania sh.p.k.
Tirane, Rr:"Kavajes", ish Kombinati Ushqimor
web: www.bat.com
office phone: +355 (0) 42 255084

VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 13 Shkurt 2019

GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Allaj

"BULEVARDI POLITIK"

- Edi Paloka poston foto me Dua Lipën: Super e suksesshme
- Princ Filip 97 vjeç, dorëzon patentën: Pas aksidentit reflektova
- Princ Harry dhe Meghan vazhdojnë të thyejnë traditën mbretërore...
- Gjika me Tahirin: Miq të mirë, edhe në kohë të vështirë


Partneri 11 vite më i ri, ja sekreti i lidhjes së Diellza Kolgecit



"Nuk shpjegohet dot me fjalë"! Marsela Çibukaj emocionon me fjalët për lidhjen e saj



Nga Anjeza Shahini te Shpëtim Saraçi, ja njerëzit e famshëm që u "zhdukën"



Largohen nga fama, ish-VIP-at që bëjnë një jetë normale

Këngëtarë, moderatorë apo kompozitorë, pse këta personazhe zgjodhën të dalin nga "prozhektorët"

Nga Anjeza Shahini te Shpëtim Saraçi, ja njerëzit e famshëm që u "zhdukën"

Largohen nga fama, ish-VIP-at që bëjnë një jetë normale

Këngëtarë, moderatorë apo kompozitorë, pse këta personazhe zgjodhën të dalin nga "prozhektorët"

Pamela Aliaj

Të gjithëve në fillim u pëlqen fama dhe të qenurit në qendër të vëmendjes, por mesa duket disa personazhe të njohur në publik, thjesht nuk e kanë në plan të bëhen të famshëm, ndërsa të tjerë e kërkojnë me patjetër famën në të gjitha mënyrat. Mbasse mendoni se të qenit në qendër të vëmendjes është ëndrra e çdo personi që shihni në televizion, por do t'ju vërtetojmë se disa VIP-a nuk zgjodhën të ndiqnin këtë rrugë. Nga A-ja deri tek Sh-ja po ju listojmë disa personazhe që do t'ju provojnë të kundërtën. Më poshtë do të njiheni me disa të famshëm shqiptarë që hoqën nga jeta si "VIP" për një jetë normale.

ANJEZA SHAHINI

Prej kohësh këngëtarja Anjeza Shahini është larguar nga Shqipëria për të jetuar me bashkëshortin e saj, me të cilin u njoh në Tiranë, gjatë kohës që ai punonte si diplomat. Edhe pse nuk shohim shumë postime nga jeta e saj e përditshme në rrjetet sociale, ajo bëri një postim në trevjetorin e martesës. Këngëtarja e njohur, Anjeza Shahini, do të bëhet nënë për herë të parë. Këtë lajm të bukur e ka treguar vetë ajo nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale, ku shfaqet duke dalë nga pishina me barkun e rrumbullakosur. Ndërkohë kujtojmë se pas martesës me diplomatin Paul Edward Conolly, Anjeza u shpërngul në Angli dhe u largua nga skena shqiptare, duke lënë pas kështu një karrierë të gjatë, nëse i referohet



"Top Channel", gjithashtu përfaqësuesja e Shqipërisë në "Miss Universe", prej disa vitesh është bërë nënë dhe është zhvendosur në Gjermani së bashku me bashkëshortin, ku punon në një qendër sociale për familjet dhe fëmijët në nevojë, ku ajo kujdeset për programin e artit dhe kulturës.

GERTA HETA

Ka qenë një ndër figurat e njohura të "Top Albania Radio" dhe "Top Select", por tashmë ish-moderatorja dhe këngëtarja Gerta Heta nuk është pjesë e ekranit. Sot Gerta punon në prapaskenë. Ajo është drejtore e përgjithshme e "Kiss FM" dhe bën zërat e reklamave të një kompanie të njohur telefonike në Shqipëri.

JOANA SMAKAJ

Mjaftoi një këngë që ajo të tërhiqte vëmendjen e të gjithëve. Biondina bukurash e ekranit shqiptar, Joana Smakaj, që u bë e njohur me këngën "Zemrën ndeze" na ka munguar. Ajo i është përkushtuar rritjes së dy fëmijëve dhe vetëm një vit më parë ka fituar provimin e noterisë.

LEDINA ÇELO

Nuk ka ditë që të mos dëgjojmë dhe shohim një foto të mamit seksi Ledina Çelo. Ajo na përditëson me të rejtat nga shtëpia e saj dhe fëmijët e mrekullueshëm. Por Ledina Çelo është larguar nga muzika dhe ekranit. Herën e fundit që e pamë në skenë ishte kur prezantoi spektaklin që u mbajt në nder të 50-vjetorit të karrierës së Sabri Fejzullahut. Aktualisht Ledina merret me bizneset e bashkëshortit në Gjermani. Megjithatë, ajo nuk ka hequr dorë përfundimisht nga muzika: "Ndihehem unë në mikrofon. Kur jam në një klub nate ku këndohet live" dua të kap mikrofonin. Tani këndo për fëmijët dhe performoj për bashkëshortin", është shprehur në një intervistë.

ORNELA BREGU

Ajo ka qenë një ndër figurat më të dashura të ekranit shqiptar, por Ornela Bregu prej gati një viti është vendosur në Spanjë së bashku me bashkëshortin dhe dy fëmijët e saj. Ish-moderatorja e disa programeve televizive në "Top Channel" u komentua se ishte vetëm për pushime në Spanjë, por shumë shpejt u kuptua se do të rrinte më gjatë. Arsyeja e këtij largimi lidhej me fëmijët e saj, të cilët nisën studimet në Spanjë.

SHPËTIM SARAÇI DHE**MIRA KONÇI**

Ndonjëherë disa gjëra bëhen për hir të fëmijëve! Kompozitori ynë i njohur Shpëtim Saraçi dhe këngëtarja Mira Konçi vendosën para disa muajsh të largohen drejt SHBA-ve për të nisur një jetë të re. Ky largim erdhi menjëherë pasi Shpëtim Saraçi u hoq nga puna pranë TVSH-së. Ishte vetë kompozitori Saraçi, ai që e dha lajmin e largimit, duke u shprehur i zhgënjyer nga Shqipëria.

mi moshës si adoleshente kur u shfaq për herë të parë në "Ethet e së premtes mbrëma".

ARBER ARAPI DHE MARSIDA SARAÇI

Pasi u njohën në spektaklin "Ethet e së premtes mbrëma", Arber Arapi dhe Marsida Saraçi janë martuar bashkë dhe janë bërë prindër të një vogëlusi. Ata janë tërhequr nga ekranit dhe nuk dimë nëse e kanë në plan rikthimin.

BUBULINA KRASNIQI

Bubulina Krasniqi, e cila tani është diplomate në Bullgari, një herësh edhe e fejuar me djalin e ambasadorit kosovar në Bullgari. Dikur kishte edhe disa këngë që ishin shumë të pëlqyera nga pub-

liku, por ajo me të cilën Bubulina bëri më shumë buj ishte kënga "Elementi i 5". Sado që këngët e saj u dëgjuan shumë, duket se e vogla e familjes Krasniqi vendosi që të shkoj hapave të vëllait të saj duke u marr me politikë.

DAFINA REXHEPI

Dafina Rexhepi me këngën e parë u pëlqye shumë, duke u krahasuar kështu me këngëtarët më 'in', siç është Dafina Zeqiri. Por, këngëtarja pas disa këngëve të realizuara si në bashkëpunim, ashtu edhe solo, tani nuk është më prezente në skenë. Duket se Dafina qëndron në Gjermani dhe iu është përkushtuar studimeve atje. Kënga e parë e saj ishte "Ti mi then


kufijt", këngë kjo që ishte në bashkëpunim me Etno Engjujt.

FLORIANA GARO

Floriana Garo ka vetëm pak muaj që ka sjellë në jetë fëmijën e saj të parë, të cilën e pagëzoi me emrin Adia dhe u largua nga ekranit për t'u bashkuar me bashkëshortin e saj në Gjenevë. Pas largimit, të gjithë nisëm të pyesim nëse do ta shohim më në ekran ish-"Miss Shqipërinë". Në një intervistë për emisionin "Pop Culture", Floriana bëri të ditur se nuk ka plane të afërta për t'u rikthyer në botën e televizionit, por që gjithmonë mbetet një opsion i hapur.

ERALDA HITAJ


Ish-moderatorja bukurash e



Ajo është një nga këngëtaresh shqiptare me famë botërore, e cila po shijon momentet e suksesshme të karrierës së saj, ndonëse jeta personale duket se ka mbetur në hije për artistin. Pak më parë, Era Istrefi ka publikuar dy foto buzë pishinës teksa si koment përdor tekstin e një kënge të njohur që përkthehet. "Ndahu nga e dashura, sepse jam e mërzitur" ndërsa menjëherë ka komentuar edhe DJ i njohur Diplo, me të cilin flitet se artistja shqiptare mund të ketë nisur një romancë. Mes komenteve ngacmuese ndaj Erës, DJ ka shkruar më tej një koment që ka tërhequr vëmendjen e gjithë fansave i shkruan: "Do të divorcohem për ty", duke bërë që edhe njëherë të nisin zërat se dy artistët po shoqërohen me njëri-tjetrin. Era Istrefi dhe producenti i famshëm kanë nisur njohjen që përpara hitit "Live it Up", që mban firmën e tij e madje thuhet se ishte ai që bëri që Era të ishte pjesë e këngës së njohur të Kupës së Botës së Rusisë FIFA 2018. Edhe më herët dyshja ka shkëmbyer komente ku i shprehin dashurinë njëri-tjetrit në rrjetet sociale si ky më poshtë. Ndërkohë që më parë është dyshuar se këngëtarja ishte në një marrëdhënie me një tjetër këngëtar anglez, por që asnjëherë nuk u konfirmua lidhja e tyre nga dyshja.




Habit Era Istrefi: Lëre të dashurën se jam e mërzitur. DJ botëror deklaron: Do divorcohem për ty



Gjatë ditës së martë në mediat rozë bëri bujë lajmi se aktori i njohur Rezart Veleshnja nëpërmjet disa postimeve në "Instagram" nxori zbuluar tradhtinë e partneres së tij, duke treguar se ajo kishte 4 lidhje të tjera ndërkohë që ishte me të. Por me vonë nëpërmjet disa videove aktori sqaroi se i kishin vjedhur "Instagram"-in dhe se postimet nuk i kishte bërë ai. Ndërkohë që e gjithë vëmendja e publikut ishte fokusuar tek kjo ngjarje, moderatorja e njohur e "Portokalli" ka zbuluar se fundmi sherrin që ka pasur me Rezartin. Në një rrëfim për emisionin "Sekretet e Portokallisë", Xhemi Shehu ka treguar një ngjarje që i ka ndodhur pak kohë më parë me aktorin në fjalë. Siç rrëfeu moderatorja, asaj i është dashur që të bëjë një pjesë me Rezartin, mirëpo ai e zgjati aq shumë pjesën e vetë sa që Xhemi u detyrua t'i bërtiste dhe t'i kërkonte të nxitonte në mënyrë që të mbaronin. Por Rezarti nuk e ka pritur aspak mirë këtë gjë dhe e ktheu të gjithë pjesën në një monolog, duke mos e përfshirë Xhemin. "Iku dhe më la si peme", tregoi Xhemi dhe më pas tha se për 2 javë ata të dy nuk folën me njëri-tjetrin.

Pas deklaratave për tradhti të bashkëshortes, zbulohet sherri mes Rezartit dhe Xhemi Shehut

Pra pak ditësh modelja bukuriose Diellza Kolgeci së bashku me partnerin e saj, Fisnik Rugova, organizuan festën "BabyShower", ku zbuluan për gjithë të ftuarit se priten të bëhen prindër të një vajze. Shumë prej nesh për Diellzën dinë shumë për hir të së vërtetës, ndërsa për partnerin e saj shumë pak. Kush është Fisnik Rugova dhe sa kohë është së bashku me Kolgecin? Partneri i saj është basketbollist dhe është 11 vite më i ri se Diellza. Sipas "Panorama Plus", burime pranë çiftit kanë treguar se Diellza dhe basketbollisti njihen prej shumë vitesh duke qenë se të dy jetojnë në Prishtinë, megjithatë lidhja e tyre e dashurisë ka nisur vetëm një vit më parë. Edhe pse kanë një vit të lidhur, tanimë marrëdhënia e tyre duket se do përforcohet më shumë me ardhjen në jetë të foshnjës.



Partneri 11 vite më i ri, ja sekretet e lidhjes së Diellza Kolgecit



Janë disa gjëra apo ndjenja që nuk mund të shpjegohen me fjalë. Ndërkaq, vetëm me një postim këngëtarja e njohur shqiptare, Marsela Çibukaj ka konfirmuar se është e dashuruar me këngëtarin Vitmar Basha. Përmes disa fotove të shkëputura nga koncerti i Vitmarit, i cili prezantoi albumin kushtuar Marselës, këngëtarja ka konfirmuar romancën. "Ka gjëra që nuk mund të shpjegohen me fjalë, veçanërisht dashuria", shkruan Marsela. Në fillim të shkurtit, këngëtarja e njohur Çibukajn. Në një intervistë për emisionin "Lart e poshtë" ndër të tjera ai pranoi se motivi i tij për albumin e ri është pikërisht ajo. Vitmari theksoi se Çibukaj ka qenë shtysa kryesore e gjithçkaje dhe e ka quajtur këngëtarin muzë të tij. Një dashuri e lindur duke ndarë të njëjtin pasion.

"Nuk shpjegohet dot me fjalë"! Marsela Çibukaj emocionon me fjalët për lidhjen e saj

BULEVARDI

POLITIK

Na merrni seriozisht!

Edi Paloka poston foto me Dua Lipën: Super e suksesshme

Demokrati Edi Paloka postoi një foto me këngëtareshen me origjinë shqiptare, Dua Lipa, në shenjë vlerësimi për suksesin që ajo arriti në ndarjen e çmimeve "Grammy". "Bravo Dua! Super e suksesshme, super e famshme dhe super modeste", ka shkruar deputeti Edi Paloka krahas fotos së postuar. Kujtojmë se mbremjen e së dielës Dua Lipa u shpall fituese e dy çmimeve prestigjioze, "Grammy", në ceremoninë e zhvilluar në Los Angeles.



Princ Filip 97 vjeç, dorëzon patentën: Pas aksidentit reflektova

Princ Filipi vendosi të heqë dorë nga patentja në moshën 97-vjeçare. Lajmi u bë i ditur nga Buckingham Palace. Me sa duket, Duka i Edinburgut pas aksidentit të ndodhur pak javë më parë ka reflektuar dhe ka vendosur të heqë dorë nga patentja. Ai tha se pas aksidentit ka reflektuar gjatë dhe ka vendosur të heqë dorë. Kujtojmë që më 18 janar makina e tij tip "Land Rover" u përplas me një tjetër në të cilën ndodhej një grua dhe një fëmijë. Princi nuk u lëndua nga aksidenti, ndërsa Emma Fairweather, nënë e një fëmije pësoi lëndime. Kjo e fundit në një deklaratë për mediat pak ditë pas aksidentit ka thënë se princ Filipi, i cili ishte dhe shkaktri i aksidentit, nuk i kishte kërkuar as falje për gjithçka ndodhi. Pas shumë kritikave që mori, ai i shkroi një letër në të cilën thuhet se ndihej shumë i pikëlluar për aksidentin.



Gjika me Tahirin: Miq të mirë, edhe në kohë të vështirë

Ish-kryebashkiaku i Vlorës, Shpëtim Gjika shfaqet i qeshur përkrah ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri, në një foto të publikuar në "Facebook". Megjithatë fotografia është e vjetër, kjo dallohet nga mjekra e gjatë e Tahirin, ndryshe nga çfarë u shfaq para dy ditëve të Krimit të Rënda. Gjika e shfaq foton me një mesazh kuptimplotë për të. "Miq të mirë, edhe në kohë të vështirë", shkruan Gjika teksa poston edhe ikonën e dy gishtave lart, në shenjë fitoreje ndoshta për vendimin e dy ditëve më parë të Prokurorisë ndaj Tahirin. Prokuroria e Krimeve të Rënda vendosi të mos zgjasë më hetimet për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri, një vendim që u konsiderua si fitorja e parë e tij në këtë betejë në dukje të gjatë.



Princ Harry dhe Meghan vazhdojnë të thyjnë traditën mbretërore...

Thyerja e traditave tashmë është kthyer në një zakon për Meghan Markle dhe për princ Harry-in dhe këtu nuk bën përjashtim edhe lindja e fëmijës së tyre. Sipas disa burime pranë çiftit, Dukës dhe Sussex, e cila do të lindë në prill, do të përdorë teknikën e "hypnobirthing" për të lehtësuar dhimbjet e lindjes. Për këtë ajo ka punësuar një asistent për ta ndihmuar para, gjatë dhe pas lindjes. Kjo teknikë është përdorur nga nënat e famshme si Angelina Jolie, Gisele Bündchen dhe Giovanna Fletcher. "Hypnobirthing" përshkruhet si "një formë e njohur, logjike dhe efektive parapërgatitore" që mund të ndihmojë në lehtësimin e stresit dhe ankthit.

Këshilla

Nesër është dita e "Shën Valentinit" dhe ju akoma s'e keni gjetur dhuratën për partnerin? Për "Shën Valentin" nuk ka edhe shumë rëndësi vlera materiale se sa ideja, mendimi dhe origjinaliteti. Përgjithësisht për meshkuj është akoma më e vështirë të zgjedhësh se për femrat, të cilat kanë më shumë alternativa. Por mos u shqetësoni, ne po ju propozojmë disa ide për meshkuj dhe femra që ta bëni këtë "Shën Valentin" të paharueshëm.

Cfarë t'i blini një meshkulli për "Shën Valentin"? PARFUM

Po, parfum pavarësisht mendimit që parfumi sjell ters, kjo është një nga dhuratat më të përdorura për këtë ditë. Zgjidhni një aromë, të cilën ju e pëlqeni shumë dhe me siguri edhe partneri do ta përdorë përdorisë ju e adhuronit atë aromë. Një opsion tjetër është blerja e një seti SPA, ku mund të ketë: parfum, xhel dushi, deodorant, aftershavë etj. Një set SPA është një dhuratë e përshatshme si për meshkuj, edhe për femra.

TE BRENDSHME

Thyeni monotoninë në shtrat me një palë të brendshme speciale. Diçka provokuese, e pazakontë mund t'ju argëtojë të dyve.

Diçka elektronike
Tashmë dihet që meshkuj janë më të prirur për gjëra elektronike se sa femrat. Zgjidhni një MP3, 'iPod', 'playstation' apo celular të teknologjisë së fundit. Të jeni të sigurt që dhurata do t'i pëlqejë.

Kornizë+foto
Një kornizë e bukur bashkë me një foto tuajën që ju kujton një moment special, ndoshta bardh e zi, është një ide për meshkuj që pëlqejnë gjërat romantike. Edhe pse kujtimet janë gjithmonë në mendje dhe në zemër, stampimi i tyre në foto bën që t'i ripërfjetoni sa herë që t'i shihni. Dhe kjo është një ndjesi e bukur.

Cfarë t'i blini një femre për "Shën Valentin"? ÇOKOLLATA

Ashtu si edhe lulet, çokollatat janë një nga dhuratat standarde për "Shën Valentin", por asnjëherë jashtë mode. Femrat i adhurojnë ndoshta edhe për faktin që çokollatat kanë cilësi afrozodiakale (që rrisin dëshirën seksuale). Zgjidhni një çokollatë të zezë me 70% ose më shumë kakao. Ose përgatisni një shportë me çokollata të vogla me shije të ndryshme, bashkë me një shishe shampanje e një dedikim.

TE BRENDSHME

Të brendshmet janë një



Nesër është "Shën Valentini", ja disa ide dhuratash që nuk do t'ju lënë në baltë

"Ai" dhe "Ajo", një kujtim që do të qëndrojë në mendje për një kohë të gjatë



ide shumë e mirë edhe për femrat. Duke qenë se ka edhe më shumë alternativa, s'do e keni shumë të vështirë të zgjidhni. Ju sugjerojmë të blini ato me pjesë dantelle, në ngjyrë të kuqe apo të zezë. Këto janë më provokuese dhe kjo mund të jetë edhe një dhuratë për ju që nuk do rrini pa e shijuar këtë "show".

BIZHUTERI

Femrat i duan aksesoret edhe bizhuteritë. Varëse, vathë, unazë, të çnuara ose jo, ato do jenë një kujtim i kësaj dite. Edhe pse thonë që diamantet janë miqtë me të mirë të femrave, jo të gjithë mund ta përballojnë këtë. Por mos u shqetësoni, femrat e vlerësojnë edhe një bizhuteri të thjeshtë.

RROBA PREJ MËNDAFSHI

Materiali i mëndafshit nuk është vetëm i bukur, por edhe shumë i rehatshëm. Një fustan i mëndafshit, bluzë apo edhe një shall e bën një femër të ndjehet mirë dhe më joshëse.

Dhurata për "Shën Valentin" unisex

Nëse e keni lënë për minutën e fundit, ka akoma ide për të dy ju.

NJË DARKE ROMANTIKE

Rezervoni në një restorant elegant, ku nuk keni qenë më parë. Një darkë vetëm të 2 ndoshta është diçka që ju ka munguar, veçanërisht nëse jeni të martuar prej disa vitesh. Ose

mund të përgatisni vetë një menu speciale, me ushqime afrozodiakale, të krijoni atmosferën e duhur me qirinj, muzikë dhe shampanjë. Gjithçka duket perfekte.

NJË DITË NË SPA

A keni shkuar ndonjëherë të dy bashkë në një qendër SPA? Provojeni dhe do të jetë një eksperiencë që do të doni ta përsërisni. Për "Shën Valentin" ka paketa dhe oferta pa fund. Zhytuni kënaqësinë dhe relaksin që të ofron një masazh me vajra esenciale, një banjë turke apo sauna. Disa qendra ofrojnë për këtë ditë speciale edhe çokollata, gotë me shampanjë apo lule. Bëni edhe ndonjë foto për ta kujtuar këtë ditë, megjithëse vështirë të harrohet.


UDHËTIM

E kush nuk i pëlqen udhëtimet? Blini 2 bileta dhe bëjani surprizë partnerit. Jo domosdoshmërisht duhet të jetë në Paris apo Venecia, çdo vend në det apo në mal, jashtë apo brenda vendit është një ide super. Bora nuk ka shkrirë akoma, e nëse nuk keni shkuar për ski këtë vit, është rasti më i mirë ky. Agjencitë turistike ju ofrojnë shumë opsione dhe paketa. Shpresojmë t'ju kemi qartësuar sado pak mendimet e t'ju kemi ndihmuar në zgjedhjen e një dhurate për partnerin. Gëzuar "Shën Valentinin" të gjithë të dashuruarve!


99 VJETORI

Tirana bardh e zi kur ndërtohej me plan

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave shfaq imazhe e dokumente të kryeqytetit



Një memorandum për ndërtimin e Tiranës (1924) shoqërohet me një hartë të lagjeve të Tiranës në dukje të vizatuara me dorë. Po me dorë shënohet: "Lagje e re", "Ismail Efendi", "Abudlla bej", "Quartier poshte", "Quartier de Tabak", "Quartier de Sulejman Pasha", etj.



Fatmira Nikolli

Tirana e vjetër shfaqet me bandën mbretërore, me Urën e Tabakëve, me gra e burra me veshje popullore, por edhe allafrënga. Përkrah bandës mbretërore, janë karnavalet si festoheshin atëkohë (1922), me kukulla që interpretojnë para publikut e qytetarë që mbathin opinga. Matanë, pesë burra pozojnë me qeleshe në kokë e jelek të veshur, këmbë mbi këmbë e mustaqet dredhur. Në gjashtë imazhe Tirana e fillimit të 1900-ës të shfaqet në thjeshtësinë e magjinë e vet. Kjo është vetëm njëra prej stendave të ekspozuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave pranë rrugës së Toptanëve dhe kalasë së qytetit. Shkas për ekspozitën u bë 99-vjetori i shpalljes kryeqytet, për çka dokumente e vendime të njohura rishfaqen për të kujtuar rrugëtimin 99-vjeçar të një qyteti që nga shtëpitë e qerpiçta e rruginat me kallëdrëm është mbushur me qiellgërvish-të; të një vendi që kishte kinematë "Savoja", "Rozafat", "Tomori", "Imperial", "Rex" (ose ish 17-Nëntori) dhe Teatrin Kombëtar siç e njohim ne sot, që është edhe i vetmi që qëndron në këmbë, ende. E varfër dhe e magjishme, me hijeshinë e bardhësisë që dëshmon kohën, minimaliste e njëherësh estetike, kryeqyteti

kur mori titullin e kryeqendrës së shtetit kish-te e përfaqësonte një unitet në ndërtim, stil e kulturë. Doemos do ketë pasur edhe baltë, kanale, e ujëra që derdeshin rrugëve, por zhvillimi nuk i ka eliminuar as sot. Ka mes stendave një vendim ku shënohet "Vendim i Katundarisë së Tiranës mbi sjelljen e një inxhinieri nga jashtë për të kryer planimetritin e qytetit". Vendimi është i vitit 1922 dhe është firmosur nga kryeqytetari.

Të krekosur shfaqen zëngjinët e kohës, anëtarë të Bashkisë së Tiranës më 1923: Myhtar Agolli, Jashar Erebara, Alo Begeja, Ali Ndroqi e Sadi Pashollari. Por në atë krekosje prej zotnije, përtej kostumeve, kravatave e këpucëve lustrafin gjen parinë e kohës që përcjell me imazhin e lënë një farë kaste që përfaqësonte diçka përtej vetes.

Një memorandum për ndërtimin e Tiranës (1924) shoqërohet me një hartë të lagjeve të Tiranës në dukje të vizatuara me dorë. Po me dorë shënohet: "Lagje e re", "Ismail Efendi", "Abudlla bej", "Quartier poshte", "Quartier de Tabak", "Quartier de Sulejman Pasha", etj. Në fund, në vend të logos, lexohet "Plan de ville de Tirana".

Kishat dhe xhamitë zinin pozicione të rëndësishme në qytet. Një kolazh bardhezi i tyre vjen në një stend të veçantë, ku mund të shquhen kisha katolike e Ti-



ranës që është sot në Rrugën e Kavajës, ndërtimi i kishës së Shën Prokopit dhe xhamia e Ethem Beut në qendër. Përreth saj nuk shquhet asgjë. Ajo duket të jetë në mes të një fushe sikundër edhe Xhamia e Karapicëve. Në stenda të tjera shihen ndërtime private ndër vite: që janë kryesisht vila, me një stil tërheqës, kafe "Kursalit",

hoteleve në zë të kohës "Continental" dhe "Donika", derisa mbërrijmë te ndërtimi i kompleksit të ministrive, Kryeministrisë, konvikte, shtëpi shëndeti, instituti "Kyrias" në Kamëz. Të dokumentuara janë edhe statuti i Sport Klub "Tiranës", statuti i klubit të tenisit dhe njoftimi mbi zhvillimin e kampionatit të parë kombëtar të atletikës më 1929.

Intervista

e Ditës

Meta: E ardhmja e Ballkanit nuk është ndryshimi i kufijve

Ian Pelhan Turner

(vijon nga faqja 1)

...a e keni ju ndjesinë se të genit gjithmonë pozitiv në politikë është shumë e rëndësishme?

Presidenti Meta: Padyshim që vullneti pozitiv dhe energjia pozitive janë të domosdoshme për t'i lëvizur ngjarjet dhe zhvillimet në një perspektivë të qëndrueshme dhe të shëndetshme, larg frymës së konfliktualitetit, si në politikën e brendshme, aq më tepër në politikën rajonale dhe në politikën e jashtme.

Dhe unë besoj se fuqia kryesore e Shqipërisë ka qenë pikërisht duke shprehur këtë pozitivitet në politikën e jashtme, sidomos në raport me fqinjët dhe në gjithë bashkëpunimin rajonal, duke qenë gjithmonë një shtyllë e fortë e stabilitetit rajonal dhe e integritimit europian. Unë kam qenë gjithmonë i përkushtuar për afirmimin e këtij vizioni të Shqipërisë dhe për implementimin e tij konkret në të gjitha detyrat dhe funksionet që kam pasur, përfshirë edhe vitin 2010 kur unë kam qenë ministër i Jashtëm dhe zv.kryeministër.

Gazetari: Ju njiheni dhe si një reformator i madh, keni punuar në sistemin makro-ekonomik, keni ndërtuar sistem me të mirë infrastrukturor, keni pasur suksese në strategjinë e privatizimeve në ekonomi. Sipas jush, cila është fusha më e suksesshme në të cilën keni punuar gjatë karrierës suaj?

Presidenti Meta: Ju përmendet disa nga fushat kryesore, ku në veçanti gjatë periudhës që unë kam qenë kryeministër janë shënuar disa progresë të dukshme, sidomos në raport me të kaluarën, përfshirë këtu edhe rritjen ekonomike mjaft të lartë në atë kohë, gati 8%. Por ka edhe mjaft elementë të tjerë, përveç këtyre që ju përmendët, sikurse është reforma shumë e rëndësishme në administratën publike bazuar në llogjin për statusin e nëpunësit civil. Tepër zhvillime pozitive në fushën e sundimit të ligjit, por më pozitivja për mua ka qenë përgatitja e Shqipërisë për procesin e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian në atë periudhë.

Gazetari: E di që keni dëshirë të mëdha dhe unë besoj se filozofia juaj është të krijoni stabilitet me vendet e tjera të rajonit. A mund të na e shpjegojë se si ndiheni në lidhje me këtë filozofi tuajën?

Presidenti Meta: Kjo është filozofia mbi të cilën është ndërtuar Bashkimi Europian, e bashkëpunimit, e bashkëjetesës për të garantuar një ambient të sigurt dhe të shëndetshëm për të gjithë

pavarësisht nga kombësia, pavarësisht nga përkatësia fetare apo përkatësive të tjera. Dhe unë besoj se për Ballkanin kjo ka qenë dhe mbetet tepër vitale.

Integritimi europian ka qenë dhe mbetet ende fuqia më inkurajuese për transformimin e këtij rajoni gjithmonë bazuar në bashkëjetesë dhe duke i kthyer shpinën nacionalizmit të sëmurë dhe provokativ, i cili ka shkaktuar drama të jastëzakonshme, jo vetëm për rajonin tonë, por edhe për kontinentin.

Në këtë drejtim filozofia kryesore është pikërisht kjo, se në Ballkan vetëm bashkëjetesa mund të funksionojë për arsye sepse çdo komb në Ballkan është shumicë në një shtet, është pakicë në një apo në disa shtetet të tjera. Dhe e vetmja zgjidhje është pikërisht, të gjithë vendet të respektojnë sipas standardeve europiane të drejtat e pakicave.

E ardhmja e Ballkanit nuk është ndryshimi i kufijve, por është heqja e kufijve si në vetë Bashkimin Europian. Kjo është filozofia kryesore që më ka motivuar mua të punoj mjaft ngushtë me të gjithë fqinjët dhe me vendet e rajonit tonë, me të cilat në të kaluarën për arsye të ditura kemi qenë në një marrëdhënie jo miqësore.

Gazetari: Të kthehemi në temën e tënit pozitiv. Çfarë dëshiron të shohësh për vendin tënd në 2019-n dhe çfarë dëshironi të shikoni si të ardhmen e vendit tuaj?

Presidenti Meta: Gjatë këtij viti unë do të doja shumë që ne të çelënim negociatat për anëtarësim në Bashkimin Europian. Do të ishte një arritje pozitive për Shqipërinë dhe këtë ta arrinin bashkë me fqinjën tonë, Maqedoninë, që arriti një sukses të madh duke zgjidhur çështjen e emrit me Greqinë, duke qenë e gatshme tashmë për t'u anëtarësuar edhe në NATO.

Së dyti do të dëshiroja shumë që të kemi edhe një finalizim të suksesshëm të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, pasi kjo do të ishte vendimtare për forcimin e paqes, stabilitetit dhe të bashkëjetesës në rajonin tonë, por edhe për të garantuar perspektivën europiane të dy vendeve, si të Serbisë edhe të Kosovës njëkohësisht.

Gazetari: Ne mbulojmë gjerësisht Diasporën në Europë dhe në Angli veçanërisht. A mund të jepni një mesazh për shqiptarët që jetojnë në vendin tonë?

Presidenti Meta: Shqiptarët në Britaninë e Madhe janë një komunitet mjaft i rëndësishëm për ne dhe janë të kudogjendur. Unë sa

herë kam pasur rastin të vizitoj Britaninë e Madhe, jo vetëm në Londër, por edhe në qytete modeste apo më periferike, gjithnjë kam takuar shumë bashkatdhetarë. Mendoj që ata janë njerëz jashtëzakonisht punëtorë, të cilët kontribuojnë shumë edhe për familjen e tyre këtu dhe për ekonominë tonë kombëtare, ndaj të cilëve duhet të tregojmë edhe më shumë vëmendje dhe kujdes në të ardhmen.

Dhe shpresojmë që një ditë shumë prej tyre të rikthehen në vendin tonë, të investojnë njohuritë dhe gjithcka ata kanë arritur atje për zhvillimin e Shqipërisë. Ashtu sikurse jam i sigurt se duhet të bashkëpunojmë edhe më ngushtë me Britaninë e Madhe për të goditur në mënyrë më të fortë dhe më efektive disa elementë kriminalë, të cilët janë një pakicë e përpërlshme dhe që shpesh për fat të keq zënë faget e para të mediave britanike, duke cenuar imazhin e shqiptarëve në përgjithësi në Britaninë e Madhe apo edhe në vende të tjera të Europës, i cili është imazhi i njerëzve të cilët bëjnë çdo sakrificë për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Por njëkohësisht të cilët kanë një dashuri shumë të fortë për atdheun e tyre.

Gazetari: Në 53 vite karrierë, ju


jeni Presidenti i parë që kam intervistuar. Kam intervistuar kryeministër, por asnjë president më parë. Si është të jesh President i Shqipërisë?

Presidenti Meta: Për mua është një nder i veçantë që jam President i vendit tim. Në këtë detyrë mund të kishte edhe shumë figura, personalitete të nderuara, të respektuara, të afta që Shqipëria ka, ndaj dhe ndihem i privilegjuar që jam në këtë pozicion, në këtë detyrë dhe duke qenë në këtë detyrë si simbol i unitetit të popullit, si kryetar i shtetit padyshim që përgjegjësia e interesave shtetërore, kombëtare dhe interesi publik prevalon mbi çdo lloj interesi tjetër, që një politikan ka kur është në një politikë më aktive apo kur është pjesë e një partie të caktuar, apo e një shumice a pakice politike.

Kështu që kjo detyrë të jep një lartësi tjetër, jo për t'u shkëputur nga qytetarët dhe nga njerëzit, por përkundrazi për t'i përfaqësuar ata dhe interesat e tyre në një nivel kombëtar dhe po kështu edhe afatgjatë.

Gazetari: Faleminderit për kohën tuaj zoti President!

* Intervista e dhënë për ALB UK TV



Opinion

i Ditës

Hije dyshimi mbi protestën e 16 shkurtit

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... për t'i shkuar deri në fund dhe për të mos iu dorëzuar instinktit të tij të lindur për pazare.

Tradhtia dhe tallja që i bëri çadrës së demokratëve në 2017, mendësia prej tregtari për të këmbëyer kauzën e zgjedhjeve të lira me drejtoret e legalizimeve dhe OSSHE janë armiq të mëdhenj ndaj masivitetit të së shtunës.

E dyta ka të bëjë me mosbesimin e ndërsjellë PD-LSI.

Të dyja palët kanë dhënë mëse një shenjë, se ato i tremben kurvërimit të tjetres në shtratin e "armikut".

Marrëveshja e 18 majit, periudha para dhe pas saj janë shembuj brilantë se Rama përdori fillimisht LSI-në për t'ia futur PD-së dhe pastaj Lulzim Bashën për të lënë Metën jashtë teptisë.

Edhe hezitimi, herë i njërit dhe herë i tjetrit, goftë për të djegur mandatet dhe goftë për të bojkotuar zgjedhjet ka rrënjësuar thellë paranojën se të dyja partitë e mëdha të opozitës, rikthimin në plan të parë, e shohin më shumë si një marrëveshje me Ramën, sesa si rrugë që kalon përmes mposhtjes së tij.

Që opozita të rikthejë besimin, ajo duhet të tregojë se di t'i heqë qafe këto paranoja që po e gërryjnë nga brenda.

Ajo duhet të ndërmarrë akte radikale, që nuk e lejojnë të ketë më kthim në kulisat dhe pazaret e mëparshme.

Vetëm kështu, dy partitë e mëdha mund të garantojnë një tjetër dukë ngjallur njëkohësisht besim edhe tek militantët e ndërsjellë.

Një rrugë për ta arritur këtë do të qe të tentimi i diçkaje më të fortë sesa synoi Rama në 21 janar.

Goftë blloku i Metës, goftë këmbëngulja e Berishës për të mos hapur kutitë, sot duken asgjë para vjedhjes galopante me truallin e teatrit, para tenderave bastardë si ai i Unazës, para zgjedhjeve të tipit Gjushi-Avdyllaj.

Prandaj dyshja PD-LSI nuk ka tjetër rrugë veçe të provojë mak-



simumin.

Ata kanë fatin e madh se Rama e ka hequr gardhin e Kryeministrit dhe ka ngritur brenda saj sallën COD, ku venerohet kulti i tij.

Pikërisht atë mund të pushtojnë qytetarët të shtunën. Jo zyren e shefit të qeverisë, por qendrën për dialog dhe komunikim.

Le ta rrëmbejnë atë hapësirë, ku përkëdhelet vaniteti i liderit global dhe le ta shndërrojnë në një aulë ku diskutohet për demokracinë, zgjedhjet e lira, PPP-të, reformën në drejtësi dhe lidhjen e politikës me krimin. Le ta zaptojnë atë dhe të mos shkulen prej

aty duke dëshmuar se ligji mund të mos përfillet kur është fjala për të kufizuar pushtetaret.

Duke ndërmarrë këtë "sakrilegj", nuk do të kishin nevojë as për të djegur goma në bulevard, as për të thyer xhamë, as për të rekrutuar "kokëpalërë" që do përleshin me policinë, as për të ngritur një çadër bis.

Me këtë akt nuk do të bezdisnin njerëzit, por sunduesin e tyre, duke dhënë edhe njëherë mesazhin se turmen nuk e përdorin si mish për top për të pazat më të madh.

Duke marshuar vetë të parët poshtë markizës së Phillipe Parreno, Basha dhe Kryemadhi do të

jepnin një sinjal të qartë se nuk ndajne asgjë të përbashkët me modelin 'Rama', se ata nuk presin më prej tij, se ashtu sikurse tha te "Të Paekspozuarit", kryetarja e LSI-së, 16 shkurti do të jetë dita kur dikush duhet të ikë, ose kryeministri, ose ata si drejtues opozite.

Vetëm nëse ndiejnë këtë, vetëm nëse kuptojnë realitetin se kësaj here, dikë do ta heqin qafe, njerëzit mund të rigjejnë besimin për t'u derdhur në shesh. Ndërsa, në të kundërt, nëse ata ende vazhdojnë të dyshojnë se protesta e së shtunës nuk po organizohet për të shkullur "të gjatin", por për t'i lypur atij vendin e Erion Braçes, ajo do të rezultojë një dështim.

HOROSKOPI

DASHI

Dikush do të përpiqet t'ju kontrollojë. Ka gjasa të dëgjoni një thashethem për dikë pranë jush. Mos u besoni informacioneve të paverifikuara. Në mbrëmje rekomandohet që të shkoni në vendin tuaj të preferuar të argëtimit.

DEMI

Disa Dema do të kenë shumë besim në vetvete. Kjo do t'ju ndihmojë të arrini sukses në karrierë. Megjithatë, shmangni presionin e tepërt në marrëdhëniet personale. Silluni me xhentesë dhe takt. Mos provoni sporte ekstreme.

BINJAKET

Këtë të mërkurë do të përballeni me disa rrethana të ndryshme. Ka gjasa që të mos realizoni disa prej planeve tuaja, për shkak të disa arsyeve të rëndësishme. Bëni durim, pasi gjithçka do të marrë drejtimin e duhur në mbrëmje.

GAFORJA

Gaforet nuk do të kalojnë një ditë të vështirë. Disa prej synimeve tuaja do të realizohen lehtësisht. Megjithatë, mos besoni se do të ndodhin mrekullitë. Përpikuni të kontrolloni fjalët, pasi ka gjasa të ofendoni dikë.

LUANI

Luanët nuk do të kenë besim tek aftësitë e tyre sot. Ndoshta shkak i këtij pesimizmi do të jetë një incident në mëngjes. Nuk keni pse t'i provoni vetes se jeni të mirë për gjithçka. Sijlla juaj do të vlerësohet nga partneri/partnerja.

VIRGJERESHA

Të lindurit e kësaj shenje duhet t'i pranojnë këshillat e të afërmeve të tyre. Ndoshta e vërteta që ata do të thonë do t'ju tingëllojë hidhur, por bëni mirë ta vlerësoni me objektivitet atë që po ndodh rreth jush. Vazhdoni të ndiqni ëndrrat tuaja.

PESHORJA

Peshoret mund të triumfojnë sot. Ekziston një probabilitet i lartë që të shënoni sukses në marrëdhëniet tuaja personale. Sot ka gjasa të festoni në familje për një rast të veçantë. Rekomandohet të mos e neglizhoni dikë që do ju shfaqë ndjenjat.

AKREPI

Akrepat mund të bëjnë gjithçka këtë të mërkurë. Do të zgjidhni një problem shumë të ndërlikuar. Në mbrëmje nuk do të ndiheni mirë nga ana shëndetësore. Megjithatë, kjo gjendje do të kalojë shumë shpejt.

SHIGJETARI

Dita e sotme do t'ju duket shumë e gjatë dhe e lodhshme. Shanset janë të larta që të bëni gjëra që do t'ju imitojnë, ose stresojnë. Këtu mund të përshihet edhe mungesa e një këqijutimi me të afërmit tuaj, ose një mosmarrëveshje me një prej kolegëve tuaj.

BRICJAPI

Bricjapët nuk duhet të ndërmarrin sot rolin e mentorit. Personi të cilin do t'ju jepni dje nga eksperiencia juaj do të rezultojë i pakujdesshëm ose mosmirënjohës. Bëni mirë të lidheni me persona që keni besim dhe që tregojnë interes për problemet tuaja.

UJORI

Bëni kujdes me shëndetin. Mund të keni nevojë të shkoni te mjeku, ose të bëni analiza mjekësore. Mbrëmjen do ta kaloni në qetësi, të izoluar nga informacione të paveshshme.

PESHQIT

Ka gjasa të shënoni sukses në biznes. Gjithashtu, mund të komunikoni me një person me influencë. Do të karakterizoheni nga optimizmi gjatë kësaj të mërkure, i cili do t'ju ndihmojë shumë të ecni përpara.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË MOBILE DHE TABLET

KERKONI NË APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NË KOHË REALE LAJMET E FUNDIT NË APARATIN TUAJ



PRESIDENTI I KUKËSIT



Pas humbjes ndaj Tiranës këtë fundjavë, te kampi i Kukësit gjërat nuk janë aspak të qeta. Në një intervistë për "Report TV", është presidenti i verilindorëve, Safet Gjici, i cili shprehet se tekniku Cungu, do të ketë besimin e tij pavarësisht rezultateve.

NDJAJ TIRANËS - "Ishte një hap shumë fals me Tiranën nuk e besonim kurrë që do humbnim. Njerëzit dhe gabojnë, edhe trajneri,

Gjici kritikon Cungun: Të rrijë pranë ekipit, të mos ikë çdo ditë në Shkodër

por me një të gabuar nuk mund të themi se trajneri nuk e ka besimin tim. Të gjithë gojë e liga që thonë e hoqi sot e hoqi nesër e kanë shumë gabim."

KËSHILLA PËR CUNGUN - "Pres që trajneri të rrijë më afër ekipit dhe mos të shkojë çdo ditë

në Shkodër. Mos të lëvizë çdo ditë vajtje ardhje, por të rrijë këtu në Tiranë. Ti përkushtohet ekipit se është një ngarkesë e madhe të shkosh çdo ditë në Shkodër."

NDESHJET NË KAMZË - "Po të kishim luajtur në Kukës të jeni të bindur se sot do ishim +10 pikë më shumë

se Partizani. Besoj se në 15-20 shkurt do të fillojë prishja e godinës së vjetër dhe më pas do nisë me shpejtësi ndërtimi i stadiumit të ri. Do jetë më të gjithë standardet europiane."

DUKA NË UEFA - "Gjithë shqiptarët dhe gjithë Shqipëria duhet të gëzohet pasi për herë të parë një person nga vendi ynë bëhet pjesë e qeverisë së futbollit Europian. Nga kjo Shqipëria do të përfitojë shumë."

Paraqitjet e shkëlqyera të mesfushorit në Serinë B, kanë zgjuar interesin e Sampdoria



Jeton Selimi

Merr një kthesë pozitive karriera e Kristal Abazaj. Atëherë kur u mendua se sulmuesi anësor do ta mbyllte sezonin te Anderlecht po nuk po gjente aspak hapësira që pas transferimit të tij në verë të gjigandët belgë, Abazaj këtë të martë është zyrtarizuar si afrimi më i fundit i skuadrës kroate të Osijek, ku më parë është aktivizuar edhe Eros Grezda. Abazaj ka lënë Anderlechtin për të kaluar në kampionatin kroat. Te Osijek, 22-vjeçari shqiptar është transferuar në formë huazimi më të drejtë blerjeje. Merkato e dimrit në Kroaci nuk është mbyllur ende dhe ish-lojtari i Luftëtarit do të jetë pjesë e Osijek në pjesën e mbetur të këtij sezoni. Te Osijek që lufton për një vend në Kupat e Europës në kampionatin kroat, Kristal Abazaj do të ketë mundësi të aktivizohet rregullisht dhe të bëjë shpërthimin e madh për t'u transferuar më pas në një kampionat më cilësor. Edhe Eros Grezda e përdori Osijekun si një trampolinë shumë të mirë për të kaluar te Glasgow Rajnxhërs në Skoci. Gjatë eksperiencës 7-mujore te Anderlecht, Kristal Abazaj, i cili kushtoi klubit

Abazaj lë Belgjikën për Osijekun, Breshia do 4 mln euro për Ndojn

Sulmuesi nuk arriti të gjejë hapësira tek Anderlecht



belg 750 mijë euro u aktivizua në vetëm 1 takim si zëvendësues pikërisht në sfidën e kampionatit ndaj Serkell Bryzh. Edhe në këtë transferim të 22-vjeçarit një rol të rëndësishëm e ka luajtur menaxheri i mirënjohur Sh-

kumbin Qormemeti, por edhe drejtori sportiv i Skënderbeut Haris Fakiq i cili është krahuri i djathtë i Qormemetit.

NDJAJ DREJT SERISË

Sezonin e ardhshëm

Emanuele Ndoj do të luajë në Serinë A. Mesfushori i kombëtares shqiptare, i cili po spikat jo pak në këtë sezon të Serie B me fanellën e Breshias që kryeson kampionatin, po ndiqet me vëmendje nga drejtuesit e

Sampdoria, të cilët janë gatshëm ta transferojnë në skuadrën e tyre 22-vjeçar. Edhe nëse nuk arrijn të ngjijë Brescian në Serie A, sezonin e ardhshëm Ndoj sipas të gjitha gjasave do të jetë pjesë e elitës së futbollit italian duke mbajtur veshur fanellën e Sampit. Ndoj në këtë sezon ka zhvilluar në total 18 paraqitje me Breshian në Serie B, tekta numëron edhe 2 gola të shënuar dhe plot 6 asiste. Ai është një lojtar polivalent në mesfushë pasi përveç se si mesfushor qendër mund të aktivizohet edhe nga krahët dhe kjo është një nga arsyet që Sampdoria e kërkon me ngulm. Breshia për ta blerë nga Roma (klub i Ndoj) u rrit si futbolli shpenzoi 1,2 milionë euro në verë e vitit 2016-të, ndërsa tashmë drejtuesit e Breshias pretendojnë të fitojnë rreth 4 milionë euro nga shitja e talentit shqiptar.

BOKS



Përcaktohet përballja e madhe mes Ualldërit dhe Fjurit

Përballja e 2 gjiganëve të boksit Ualldër dhe Fjuri në 1 dhjetor nuk arriti të nxirrte asnjë fitues. Megjithatë për t'i dhënë fund dilemave kanë menduar vet boksierët. Sipas asaj që raporton "Daily Mail" përfaqësuesit e 2 boksierëve kanë rënë dakord për një duel tjetër. Kjo përballje do t'u sjell 20 milionë paund secilit. Ndeshja do të zhvillohet në Nju Jork në 18 maj. Fituesi do të marrë gjerdanin e "WVC", që momentalisht mbahet nga Ualldër. Ky pritet të jetë dueli më i madh për 2019-tën.

Shuhet gardiani i Anglisë kampione bote

Futbolli në zi, lamtumirë Gordon Banks



sohet si pritja e shekullit. Ish-te Botërori i vitit 1970 në Meksikë, ndërsa përfaqësuesja an-

gleze luante kundër Brazilit më të fortë në histori, të udhëhequr nga Pele. Anglia u mund 1-0 me golin e Jairzinho. Por, më parë Banks bëri një pritje të pamundur pikërisht përballë Pele. "Nuk mund ta besoj. Në atë moment e urreja Banks më shumë se çdo gjë tjetër. Por kur inati u shua, u detyrova ta uroj me gjithë shpirt. Ishte pritja më e bukur që kisha parë në karrierë", do ta përshkruante disa vite më pas vetë legjenda e futbollit botëror.

Flet drejtori i Juventusit


Paratiçi: Me Ikardin bënim lëmsh gjithçka, ndaj morëm Ronaldon

Drejtori i Juventusit dhe arkitekti i merkatos bardhezi, rrëfen në një intervistë ekskluzive për "Gazzetta dello Sport" shumë gjëra rreth verës së shkuar që pa mbërritjen në Torino të Kristiano Ronaldos. "Marrim Ikardin dhe bëjmë lëmsh gjithçka ose Ronaldon. Ajo që ndodhi më pas e dinë të gjithë, vumë në jetë atë që mediat e cilësuan si goditjen e shekullit", ka treguar Paratiçi. Më pas drejtori i Joves tregon se trajneri aktual, Masimiliano Allegri nuk do të largohet nga bardhezinjtë, pavarësisht zërave të shumtë që parashikojnë

një divorc me teknikun dhe klubin. "Allegri ka sjellë atë që na mungonte. Është ndër pesë më të mirët në botë dhe do të gëndojë te Juventusin", thotë ai. Më pas dy fjalë për blerjen më të fundit, Aron Ramsej dhe ëndrrën e madhe të tifozëve, rikthimin e mesfushorit francez Pol Pogba. "Ramsej ka një teknikë të shkëlqyer dhe luan mjaft mirë si në krah ashtu dhe si trekuartist. Sa i takon një rikthimi të Pogbas, mund t'ju them se ky është një op-

eracion shumë i vështirë". Në fund, një mendim për mentorin e tij, Bepe Marotta, i cili u largua pas 8 vitesh si administrator i deleguar i klubit, duke ia lënë stafetën pikërisht Paratiçi. U aludua se ardhja e Ronaldos solli krisjen me Marotës dhe klubin, por Paratiçi sqaron gjithçka. "Marota është mentor i im, kemi punuar bashkë që te Sampdoria. Ai nuk ka qenë kundër mbërritjes së Kristiano Ronaldos në Torino".

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

2. Një pikturë vetes.
11. Lindgren e Pippi çorapegjatës.
13. Thirrej edhe kështu Persefoni.
14. Hapin ekspozitën.
16. Ruhet pa çifte.
18. Shiroka aktor.
19. Fillojnë masat.
20. Të parat në aksion.
21. Eshhtë gara më e gjatë.
25. Inicialet Pacino-s.
26. Janë sponsor të Tiranës.
28. Pavone këngëtare.
29. Kështu thirrej Marco Pantani.
30. Dieta pa ekstreme.
32. Janë salla për projeksiione.
33. Duhet çarë më dritë.
36. Italia në tabelë.
37. Janë katrorë në sipërfaqe.
38. Williams teniste.
40. Në fillim të verës.

41. Cocker këngëtar.
43. Të fundit në tender.
44. Janë fletë trëndafili.
48. Fillojnë ideologjinë.
49. Eshhtë krahinë e Athinës.
51. Emri i Zola.
52. Hari spiune.
53. Janë kulla në xhami.

VERTIKAL

1. Njësi matëse për kondensator.
2. Artet pa re.
3. Fillojnë uraginin.
4. Nisin titrimin.
5. Janë në modë.
6. Inicialet e Kokoschka-s.
7. Një mund të jetë ekspres.
8. Mund të jenë ushtarake.
9. Jepen për hartim.
10. Janë të lira për hartim.
12. Eshhtë magjik ai i fatave.
15. Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
17. Një organizatë humanitare.
21. Janë shkurre.
22. Janë kapo kozakë.
23. Nino kompozitor.
24. Fillojnë teorinë.
27. Kryqyteti i asirëve.
31. Një verë në Paris.
32. Një vepër si romani.
34. Mbyllin një sherr.
35. Kompozoi një Bolero.
37. Pak mbeturina.
39. Një bëhet për të mirë.
42. Eshhtë dhomë.
44. Peter që humb hijen.
45. Një pjesë e territorit.
46. Pak amerikanë.
47. Gjysmë litari.
49. Dy asa.
50. Kalimi në kufij.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Mondrian piktor.
5. Safin tenist.
9. Eshhtë e re pas Krishtit.
10. Janë grimca të familjes së adroneve të tilla.
12. Fillojnë matematikën.
13. Mbarojnë fare.
14. Josa trainer.
15. Në mes të dhomës.
17. Gjysma e inatit.
19. Ishin shkolla edukimi.
22. Janë ritransmetues televizivë.
24. Ishte djali që vrau Odiseun.
25. Një pjesë e opozitës.
27. Një ekspres në binarë.
29. Kuqja mbajnë... e mbështesin.
30. Mund të lakohen.
32. Një yll me bisht.
34. Italia në Internet.

VERTIKAL


35. Edouard piktor.
37. Shahu i fundit.
38. Gjysma e aortës.
40. Efekt... i François Truffaut.
41. Inicialet e Lendi.
42. Kufizojnë një kënd.
44. Polanski regjisor.
46. Skuadër greke.
48. Britma e Armkimeidit.
49. Egoan regjisor.
50. Fillojnë turnin.

VERTIKAL


1. Ishte shkolla e Arkimedit.
2. Grandi këngëtare.
3. Diftong teatral.
4. I përkasin stinës së nxehtë.
5. Një shishe bombë.
6. Janë në qendër.
7. Ndiqet nga një mi.
8. Janë këngëtarë lirikë.
10. Emër burri.
11. Një personazh i interpretuar nga Woody Allen.
15. Botom pa ekstreme.
16. Eshhtë figurë letrare.
18. Eshhtë enë kryesore gjaku.
20. Një pikë në ligj.
21. Risia pa kufij.
23. Ulen në Dhomën e lartë të tillë.
26. Janë fletë trëndafili.
28. Robert Mitchum.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Eshhtë si fatë.
32. Gjysma e ketrit.
33. Carolina e belle epoques.
36. U shkrua nga Zola.
39. Me të bëhet trokë.
43. Duket të parat.
45. Maten të parat.
47. Të parat në kufij.




Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Argëtim
filozofik



Thënie
të mençura

SUDOKU

5	4						3
	1		9	5			2 7
9	2	6	3				8
							1
						9	
1			4	8	2	3	5
		8		1			2
	5				9		
3		4		8		1	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	9	5	8	4	3	2	1	6
1	3	8	2	6	7	5	4	9
6	2	4	9	1	5	7	8	3
3	1	2	7	5	6	8	9	4
5	4	7	3	8	9	6	2	1
8	6	9	1	2	4	3	5	7
9	5	6	4	3	8	1	7	2
2	7	3	5	9	1	4	6	8
4	8	1	6	7	2	9	3	5

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

7	15	3	6	4	6	6	1	4	1	7
1	15		11	8		8	6	5	L	6
17		14	8	5	8	12	1	7	8	7
	6	3	7	9	6	1	13	8	7	14
17	9	6	19	13	3	7	3	7	3	7
9	16	8	15	1	7	9	15	8	7	7
6		13	3	8	13	9		12	1	
16		4	13	13	3		6	1	5	5
1	6	3	1	13	7		17		9	4
13		9	7		8	17	3	16	9	15
3	7	13		8	7	3	5	8	13	3
1	5	3	11	3		4	3	15	7	1

T	R	A	P	A	E	F	I	K	A	S
H	E	R	O	I	Z	M	I	P	A	K
E	K	T	P	A		P	A	T	A	L
S	P	E	R	A	N	D	O	R	I	A
D	E	T	E	K	T	I	V	I	E	K
A	N	E	U	A	N	M	A	T	I	A
M	O	R	R	I	P	I		M	Z	
A	R	R	I	E	A	H	I	E		
R	E	A	L	S	E	L	L	E	R	S
E	C	A	R	A	M	A	N	E	T	I
T	R	A	K	T	I	A	A	Z	I	L

- Duam të bëhemi Zotër, dhe kjo na pengon të bëhemi njerëz.

- Mos thuaj asgjë të mirë për veten, sepse nuk do të bëhemi të besueshëm. Por mos thuaj asgjë të keqe, sepse të gjithë do ta besojnë.

- Nëse nuk jeni zotërues i rrjedhës së jetës tuaj, kjo do të thotë që ju lejoni që ekzistenca juaj të jetë një aksident.

- Shumë njerëz duan t'u japin fund maleve të vështira, kur ajo që ata vërtetë kanë nevojë është guximi për t'u ngjitur.



www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE

Gazeta e gjithë shqiptarëve!



Kontakt: +355 68 40 63 842

Facebook: Gazeta Shqiptare
Instagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube Youtube: Gazeta Shqiptare

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!



www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al